
NË KËTË NUMËR LEXONI


3 K(A)OS(K)OVA


6 Intervistë me Kaqusha Kamberin


10 Malësia e Gollakut të Bujanovcit


16 Agjensit kryesor lëvizës...


27 Mbulesa e femrës midis të kaluarës...

Lajme 2

Milazim Krasniqi: K(a)os(k)ova 3

Florije Ademi: Kush po e pengon rikthimin e shqiptarëve në veri? 4-5

Osman D. Gashi: Vasha e dashuruar me profesionin e gazetarisë 6-7

Sead Ujkani: Energjia, rol thelbësor për zhvillim ekonomik 8

Milazim Krasniqi: "Lideri i madh" i mazohizmit politik 9

Sabri Halili: Malësia e Gollakut të Bujanovcit po përjeton fatin e Toplicës së Nishit 10-11

Gëzim Qerimi: Universitetet private të Kosovës në llupën e Këshillit Britanik për Akreditim 12-13

Fitim Veliu: Testi i dilemave 14

Shehide Qerimi – Lushtaku: 400 studentë vendorë e ndërkombëtarë në UVP 15

Fadil Maloku: Agjensit kryesor lëvizës të globalizmit 16-17

Demir Reshiti: Katër njohje gjatë muajit maj... 18-19

Osman D. Gashi: Fotoreportazhi 20-21

Emine A. Vezaj: Si ta perceptoj identitetin tim në Kosovën e pavarur? 22-23

Muhamed Jusufi – Kajolli: Fjalimi lamtumirës dhe vdekja e Muhammedit s.a.v.s. 24-25

Florentina Lata: Shifra alarmante të abortit në Kosovë 26-27

Nexhat Ibrahimi: Mbulesa e femrës midis të kaluarës dhe të tashmes 27-29

Demir Reshiti: Patriot nuk të bëjnë fjalët, por veprat! 30

Flamur Maloku: Universalja thyen personalen në kohë 31-32

Gjylë Totaj: Përtej thellësive të "Fijeve të shpirtit" 32-33

Poezi 34

Berat Dakaj: Mrizi i bukurisë së njerëzve 35

Naser Shatrolli: Kulla e Parisit sinonim i kullës shqiptare 36

Ditëlind Reshiti: Festë poetike në Zgatarin e Ymer Prizrenit 37

Artan N. Bejta: Alergjia – sëmundje e ditëve të nxehta 38-39

Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 19
19 qershor - 19 korrik 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

12 qershor 2008

Prishtinë



Arrin plani i Ban Ki Moon-it për rikonfigurimin e UNMIK-ut

Ka arritur në Prishtinë letra e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon, mbi rikonfigurimin e UNMIK-ut. "Mund të konfirmoj se kemi marrë letrën nga selia qendrore në Nju Jork për presidentin Sejdiu dhe një kopje për presidentin serb, Tadiq" – ka deklaruar zëdhënësi i UNMIK-ut, Rusell Giki. Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon, u ka thënë liderëve të Kosovës se ai synon ta rikonfigurojë misionin e OKB-së atje, për të lejuar Bashkimin Evropian që të marrë përgjegjësi në çështjet kryesore. "Është synim imi që ta rikonfiguroj strukturën dhe profilin e pranisë ndërkombëtare civile në atë mënyrë që t'i mundësojë Bashkimit Evropian që ta marrë dhe ta forcojë rolin operacional në harmoni me rezolutën 1244" – shkruan Ban Ki Moon, në letrën dërguar Presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiut.

11 qershor 2008

Prishtinë

Miratohet himni shtetëror i Kosovës

Kuvendi i Kosovës me 72 vota për, 15 kundër dhe 5 abstenime ka miratuar më 11 qershor himnin shtetëror të Kosovës. Himni është një melodi pa tekst, vepër e kompozitorit Mendi Mengjiqi. Shumica e grupeve parlamentare e kanë mbështetur këtë vepër, e cila ishte koduar me shifrën "Evropa".



Grupi parlamentar i AKR-së ka shprehur hezitime rreth procedurave të miratimit të himnit, megjithatë, deputetë të kësaj partie kanë votuar veç e veç për himnin. Himni është i gjatë 58 sekonda. Në konkursin për himnin janë propozuar 134 vepra, 24 prej të cilave kanë qenë nga kompozitorë të huaj, si nga SHBA-ja, nga disa vende të BE-së, por edhe nga Rusia dhe Zelanda e re.

7 qershor 2008

Basel, Zvicër



Nis Kampionati Evropian i Futbollit

Më 7 qershor ka startuar kampionati evropian i futbollit, i 13-ti me radhë i cili për herë të parë do të zhvillohet njëkohësisht në dy shtete, në Zvicër dhe Austri. Kampionati është hapur në Stadiumin e St. Jakob Park në Bazel me ndeshjen ndërmjet ekipeve të Zvicrës dhe Çekisë. Në këtë kampionat do të marrin pjesë 16 reprezentacione që janë të ndara në 4 grupe. Kampionati përfundon më 29 qershor kur pritet të zhvillohet ndeshja finale.

4 qershor 2008

Prishtinë

"Atmosfera" ka organizuar simpoziumin për dialogun ndërfetar

Fondacioni për Kulturë "Atmosfera", më 4 qershor, në ambientet e hotelit "Grand" në Prishtinë, ka organizuar simpoziumin me temën "Domosdoshmëria e dialogut ndërfetar për paqen botërore". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm përfaqësues nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, të Kishës Katolike, nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, krijues, publicistë dhe njerëz nga fusha e shkencës nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, ndërkaq përfaqësuesi i Kishës Ortodokse, edhe pse i ftuar, nuk ishte në këtë simpozium.

Simpoziumi është organizuar në dy seanca. Në seancën e parë me kumtesat e tyre janë paraqitur dr. Milazim Krasniqi, mr. Qemajl Morina (kumtesën e ka lexuar Xhabir Hamiti), dr. Nazmi Maliqi dhe dr. Muhamet Pirraku, ndërsa në seancën e dytë Mentor Beqa, Agron Tufa, Don Lush Gjergji dhe Sabri Bajgora.



K(A)OS(K)OVA



Milazim KRASNIQI

Mbetja e UNMIK-ut si instancë pushtetore edhe pas 15 qershorit, kur pritet të hyjë në fuqi Kushtetuta e shtetit të pavarur të Kosovës, është shenjë e kaosit pushtetor që do të vazhdojë në këtë vend. Psikologjia pushtetore e UNMIK-ut, e çimentuar në këta nëntë vjet, zor se mund të çrrënjoset me çfarëdo "konfigurimi" të Ban Ki Munit ose të kujtdo tjetër. UNMIK-u, në këta nëntë vjet, ka pasur në duart e veta pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor. Të gjitha këto në duart e një personi: të Përfaqësuesit Special. UNMIK-u ka menaxhuar edhe të gjitha ndërmarrjet publike, ka administruar edhe privatizimin dhe e ka përfaqësuar Kosovën. Pushteti monarkik i UNMIK-ut, me një këso përvoje dhe veçmas pasojat e abuzimit të këtij pushteti, vërtet nuk do të mund të rikonfigurohen. E vetmja mënyrë e shkëputjes nga ajo përvojë e keqe e qeverisjes dhe e administrimit ka qenë largimi i plotë i UNMIK-ut. Pra, nëse UNMIK-u vazhdon të jetë prezent si instancë pushteti edhe më tutje, kaosi do të jetë i paevitueshëm. Institucionet e Kosovës do të përpiqen të luajnë rolin e institucioneve të një shteti të pavarur, por prezenca e UNMIK-ut është dëshmi se ato nuk janë përfaqësuese të një shteti të pavarur. Rivaliteti mes tyre do të mbikëqyret nga EULEX-i, një instancë tjetër e një pushteti në hije i Bashkimit Evropian. EULEXI do të ketë mandatin e mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të veprimeve e të vendimeve të institucioneve të Kosovës, por ky mandat de facto e bën atë një pushtet më vete, ose një hiperpushtet. Piter Fejti, faktikisht, ka kapacitetin e mandatit të Përfaqësuesit Special për të anuluar vendimet që nuk janë në frymën e Planit Gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit. Kjo do të thotë se EULEXI do të jetë një pushtet rivalizues edhe me institucionet e Kosovës, edhe me UNMIK-un e "rikonfiguruar".

Por, kaosi pushtetor në Kosovë do të jetë edhe më i gjerë, falë indiferencës së UNMIK-ut dhe të institucioneve të vendit në periudhën transitore, gjatë së cilës po nxjerr krye një pushtet paralel i serbëve. Lejimi i zgjedhjeve lokale e parlamentare serbe në Kosovë ka krijuar bazat e krijimit të "kuvendeve komunale", po edhe të "Kuvendit të serbëve të Kosovës e të Metohisë". Këto organe paralele, të cilat po konstituohen këto ditë, do të paraqesin pengesë serioze për zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve në Kosovë. Në fakt, lindja e këtij monstrumi të ri të pushtetit paralel është rezultat i strategjisë së UNMIK-ut, i cili duke e lejuar lindjen e këtij monstrumi, i ka siguruar vetes prezencën në Kosovë. Serbia dhe serbët e Kosovës ka kohë që përsërisin se e pranojnë vetëm pushtetin e UNMIK-ut. Ndërsa, UNMIK-u, nga ana e vet, duke lejuar mbajtjen e zgjedhjeve serbe dhe konstituimin e strukturave paralele i ka siguruar vetes mbijetesën, sepse tash vetëm UNMIK-u mund të qeverisë në pjesën e rebeluar të Kosovës. Emërimi i Galuqit si administrator i Zveçanit tregon se atje do të instalohen figura proserbe, të veshur me pushtetin e UNMIK-ut. Në fakt, mënyra si qeveris UNMIK-u u përgjigjet plotësisht interesave të krimit të organizuar, sepse ka disa muaj që UNMIK-u e ka lënë veriun e Kosovës pa dogana, ashtu që në Kosovë hyn mall në vlerë të miliona eurove, të cilat përfundojnë në xhepat e kontrabandistëve dhe të kriminelëve të "pushtetit paralel" serb dhe të kompanjonëve të tyre unmikianë dhe shqiptarë. Prandaj, mbetja e UNMIK-ut si instancë pushtetore në Kosovë ka rrezik ta shndërrojë Kosovën, veçmas Kosovën veriore, në një vatër kronike të kontrabandës dhe të krimit të organizuar. Nëse ky pakt i UNMIK-ut me serbët në veri dhe me Serbinë legjitimohet me një mandat të ri të UNMIK-ut, atëherë qeveria e Kosovës do të jetë e pafuqishme për ta luftuar kontrabandën dhe krimin e organizuar. Qeveria e Kosovës do të jetë si një dirigjent me duar të lidhura.

Nga përvojat e hidhura të viteve të kaluara dihet se shumë zyrtarë të UNMIK-ut kanë qenë të përfshirë në korrupsion dhe në krime, por asnjë prej tyre nuk është përballur me drejtësinë. Ata, në Kosovë, kanë qenë më të mbrojtur se lopët në Indi.

Pranimi që zyrtarët më të lartë të vendit i kanë bërë prezencës së re të UNMIK-ut në Kosovë është provë e pafuqisë së tyre. Kryetari i Kuvendit duke u munduar ta fshehë pafuqinë e institucioneve të vendit, ka arsyetuar se meqë UNMIK-u nuk ka qenë armiqësor, duhet të vazhdojë të mbetet në Kosovë! Por, me kësi kriteri do të mund të shpallej konkurs ndërkombëtar, për subjekte sa më miqësore, që t'u ofrohet mikpritje nga Kosova! Në atë rast, UNMIK-u me siguri se nuk do ta fitonte konkursin. Por, një shtet i pavarur nuk bën kualifikime të këtilla. Në një shtet të pavarur, nuk ka vend për disa instanca pushtetore njëherësh, midis të cilave edhe të një pushteti me përvojë tipike koloniale sikundër ka qenë UNMIK-u.

Por dardha e ka bishtin prapa. Prandaj, nëse ky pushtet me përvojë të hidhur koloniale vazhdon të mbetet në Kosovë me cilësime pushtetore, atëherë ka rrezik që qarqet e inkurajuara antikosovare, me në krye Rusinë,do të tentojnë ta hapin edhe një herë për "negociata direkte" çështjen e Kosovës. Me një Bashkim Evropian të përçarë lidhur me Kosovën e me një Amerikë që nga nëntori i këtij vitit mund të udhëhiqet nga një politikan i papërvojë në kaosin e Ballkanit, si Barak Obama, edhe kjo fatkeqësi është e mundshme. ■



Rindërtimi në "Luginën e Doktorëve" problem politik apo i sigurisë?

Kush po e pengon rikthimin e shqipta

Zyrtarë të KFOR-it e hedhin përgjegjësinë tek autoritetet e UNMIK-ut në lidhje me ndërprerjen e punëve në rindërtimin e "Luginës së Doktorëve", në pjesën veriore të Mitrovicës, derisa ata të UNMIK-ut thonë se kanë dhënë leje për një gjë të tillë dhe nuk është faji i tyre.



Florije ADEMI

Pas shumë përpjekjeve dhe angazhimeve të banorëve për fillimin e rindërtimit në "Luginën e Doktorëve", në pjesën veriore të Mitrovicës, para disa jave Komuna e Mitrovicës ka ndarë atje një grand prej 64 mijë euro për rindërtim.

Megjithatë, që në start, janë hasur probleme. Autoritetet e KFOR-it kanë kërkuar nga drejtuesit komunalë që të ndërpresin punimet për rindërtim në këtë kohë, për të mos tensionuar situatën.

Rexhepi: Rindërtimi në "Luginën e Doktorëve" do të vazhdojë

Kryetari i Komunës, Bajram Rexhepi, tha se autoritetet e KFOR-it kanë kërkuar që të ndalohen punët për rindërtim në "Luginën e Doktorëve", për të mos provokuar dhe tensionuar situatën. Sipas tij, arsyet e dhëna prej tyre sa i përket kërkesës për ndalimin e realizimit të projekteve ishin më tepër të natyrës politike se sa të sigurisë.

Ai tha se përkundër kësaj këto projekte do të vazhdojnë, meqë rindërtimi dhe kthimi në prona është një e drejtë që s'mund të mohohet dhe ndalohet.

"Për ne kjo kërkesë është e papranueshme dhe rindërtimi atje duhet të vazhdojë" – ka theksuar Rexhepi, duke vlerësuar se nëse rindërtimi në këtë lagje rrezikon sigurinë, atëherë kjo duhet të vlejë për gjithë veriun dhe atje duhet të ndërpriten punët edhe në lagjet e tjera, ku Qeveria e Serbisë investon në ndërtimin e objekteve kolektive për banim.

Miftari: Duam t'i rindërtojmë shtëpitë tona dhe të kthehemi të jetojmë atje

Edhe përfaqësuesi i banorëve të kësaj lagje, Musa Miftari, thotë të njëjtën gjë. Ai konsideron se rindërtimi në lagje do të vazhdojë, meqë njerëzit duan të kthehen dhe të jetojnë në pronat dhe shtëpitë e tyre.

"Ne s'kemi asnjë qëllim tjetër, as të provokojmë dikë, as të bëjmë problem. Duam vetëm të rindërtojmë shtëpitë tona dhe të kthehemi të jetojmë atje. Ne s'po mund t'i kuptojmë autoritetet e UNMIK-ut në këtë qytet, të cilët japin leje për rindërtim të rrokaqiejve të financuar nga qeveria e Serbisë dhe nuk lejojnë rindërtimin e shtëpive dhe kthimin e banorëve shqiptarë atje" – thotë Miftari.

Ai përmend, në këtë kontekst, edhe një rast absurd që ka ndodhur në lagjen e tyre, ku para një kohe ka filluar ndërtimi i një objekti shumëkatësh, i financuar nga



...rëve në veri?

Etienne de Fayet, thotë se çështja e ndërtimit të "Luginës së Doktorëve" mund të shkaktojë probleme në aspektin e sigurisë, kështu që KFOR-i mund t'u sugjerojë, gjegjësisht t'ua tërheqë vërejtjen, autoriteteve komunale në lidhje me këtë, mirëpo për të vendosur për këtë çështje, përgjegjës është UNMIK-u.

Në anën tjetër, administratori rajonal i UNMIK-ut në Mitrovicë, Gerard Gallucci, ka deklaruar se UNMIK-u qysh vitin e kaluar ka dhënë leje për ndërtimin e kësaj lagjeje.

Ndonëse fillimisht Rexhepi ka deklaruar se stopimi i punëve është kërkuar nga pjesëtarët e KFOR-it, pas një takimi që ka pasur me komandantin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it në Kosovë, Xavier de Marnak, ai tha se kjo kërkesë më tepër ka qenë analizë dhe spekulim i kreut të UNMIK-ut në këtë regjion, Gerard Gallucci, sesa kërkesë e komunitetit serb.

"Sa i përket rindërtimit në "Luginën e Doktorëve" kemi dy alternativa: njëra që komunitetet të bisedojnë mes vete dhe të dy palët të mund të ndërtojnë dhe tjetra, kërkesa për stopimin e punëve është më tepër analizë dhe spekulim i Gallucit, sesa kërkesë e komunitetit serb matanë Ibrit. Do të bisedohet me banorët dhe në rast se ky projekt ndalet, atëherë do të ndalen të gjitha ndërtimet në veri" – ka theksuar Rexhepi, për të shtuar se me Marnakun janë pajtuar në mënyre pragmatike që të veprohet me barazi e mos të ketë diskriminim.

"Nëse rindërtimi duhet të ndalet për shkak se rrezikon sigurinë në veri, atëherë kjo duhet të bëhet në gjithë veriun. Nëse strukturat e sigurisë vendosin që të ndërpritet rindërtimi vetëm në këtë lagje, atëherë ne nuk do ta respektojmë një vendim të tillë diskriminues" – është shprehur Rexhepi.

Vitin e kaluar, me ndihmën e komunës është shtruar me zhavorr rruga në këtë lagje, që konsiderohet si hapi i parë konkret i ndërmarrë në drejtim të kthimit të banorëve në pronat e tyre.

Ndërkaq, këtë vit ka filluar rregullimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, projekte këto që po sabotohen në mënyra të ndryshme nga strukturat të caktuara serbe që tentojnë të pengojnë rindërtimin dhe kthimin e banorëve.

Para lufte, në "Luginën e Doktorëve" kanë jetuar 25 familje. Një pjesë e tyre, sipas përfaqësuesit të lagjes Musa Miftari, jetojnë aktualisht në shtetet perëndimore, ndërkaq gjendja e shumicës në anën jugore të qytetit, meqë të gjitha familjet kanë qenë të ngritura dhe të arsimuara, përveç banimit, nuk ka qenë kritike për këto tetë vite të jetës së tyre si refugjatë. ■

qeveria e Serbisë. "Në hyrje të lagjes, në parcelën e vetme që është shitur aty pas lufte, para disa muajsh ka filluar ngritja e një objekti shumëkatësh të financuar nga qeveria e Serbisë, për të cilin ka dhënë leje edhe UNMIK-u". Ndërtimi i atij objekti është stopuar pas reagimit të banorëve të kësaj lagjeje, të cilët kanë kërkuar që ndërtimi të nisë vetëm atëherë kur kjo të mundësohet për të gjithë.

De Fayet: Çështja e ndërtimit të "Luginës së Doktorëve" është përgjegjësi e UNMIK-ut

Këshilltari për media i komandantit të KFOR-it në rajonin e Mitrovicës,



Bisedë me Kaqusha Kamberin, studente e gazetarisë

Vasha e dashuruar me profesionin e gazetarisë

Kaqusha Kamberi është studente e gazetarisë në universitetin AAB. Merret me media dhe gazetari që nga mosha 12 vjeçare. Ka punuar në disa radio dhe televizione lokale të Gjilanit. Dy vitet e fundit është angazhuar si bashkëpunëtore e produksionit muzikor "ARBONI" të Gjilanit, në rolin e prezantueses nëpër koncerte dhe manifestime të ndryshme muzikore që mbahen jo vetëm në Gjilan, por edhe në qytete të tjera të Kosovës dhe jashtë saj.



Osman D. GASHI

Kaqusha Kamberi ka lindur në vitin 1988 në Gjilan. Ajo është studente e gazetarisë në universitetin AAB në Prishtinë dhe merret me media dhe gazetari që nga mosha 12 vjeçare.

Ajo thekson se talentin e saj për media dhe gazetari e ka zbuluar drejtori i radios lokale te Gjilanit, "Rinia". "Pas luftës së Kosovës, edhe në Gjilan u hapën televizione dhe radio private. Kam qenë dëgjuese e rregullt e emisionit për fëmije 'Bota është e fëmijëve' i cili realizohej në radion "Rinia" dhe si dëgjuese e rregullt që isha më ftuan në një prej emisioneve të tyre ku kisha përgatitur edhe një kuiz për fëmijë. Drejtori i radios më kishte dëgjuar dhe më ftoi që unë të udhëhiqja këtë emision. Ftesën e pranova me shumë kënaqësi edhe pse nuk kisha menduar e ëndërruar asnjëherë më parë që unë të merresha me media..." - thekson Kaqusha, duke shtuar se ky talent nuk ishte krejt i rastësishëm, pasi ajo ka qenë nxënëse e shkëlqyer në shkollë, ku është dalluar edhe si poete (në revistën e shkollës 'BLETA' çdo vit i janë botuar poezitë, ndërsa si semimaturante është portretizuar në këtë revistë si nxënëse e dalluar e klasës).

Pyetjes sonë se çfarë kuptimi ka emri i saj dhe kush e ka pagëzuar me këtë emër, Kaqusha iu përgjigj: "Kaqusha është një armë (lloj mitralozi dhe lloj rakete) që prodhohet në Rusi. Prindërit ma kanë lënë këtë emër ngase atë ditë kur kam lindur, më 18 nëntor 1988, në Gjilan është mbajtur një tubim protestues ku merrte pjesë ish-kryetarja e Komitetit të LKK-së, Kaqusha Jashari. Nëna më ka treguar se si kanë pasur probleme kur më dërgonin tek mjeku për shkak të emrit, madje ka pasur raste kur edhe nuk më kanë kontrolluar fare!"

Këto ishin hapat e parë të Kaqushes dhe dashuria e saj për profesionin e gazetarisë të cilit iu përkushtua me kalimin e viteve.

Ajo ka punuar dhe ka drejtuar në radion "Rinia" emisione te ndryshme për tre vjet e gjysmë. Për një vit radhazi ajo ka udhëhequr emisionin e fëmijëve, pastaj gradualisht kaloi në emisione argëtuese për të rinj. Kuizi enigmatik, hiti i ditës, urimet dhe përshëndetjet, fontanë dëshirash, etj. janë disa nga emisionet që Kaqusha ka udhëhequr në radio "Rinia".

Kaqusha ka punuar edhe në televizionin lokal "TV Vali" si moderatore në një emision për të rinj, ku për një gjysmë viti është përballur me përvojat dhe sfidat e reja në punën në televizion. Më pas është angazhuar në një televizion tjetër lokal të Gjilanit "TV MEN", ku ka punuar për katër vite si moderatore dhe si gazetare.

Në “TV MEN”, Kaqusha ka qenë udhëheqëse e dy emisioneve, e Top Listës dhe TV Kuizi i diturisë. Gjatë punës në “TV MEN”, është angazhuar edhe në sektorin informativ ku herë-herë ka punuar edhe si spikere në lajme.

Dy vitet e fundit Kaqusha është bashkëpunëtore e produksionit muzikor “ARBONI” të Gjilanit, në rolin e prezantueses nëpër koncerte dhe manifestime të ndryshme muzikore që mbahen jo vetëm në Gjilan, por edhe në qytetet tjera të Kosovës dhe jashtë saj, si Bujanovc, Preshevë e qendra të tjera të banuara me shqiptarë.

Përvoja në RTK

Kaqusha, si rezultat i talentit dhe përvojës së saj, ka arritur të punojë si stazhiere edhe në RTK, si reportere nga terreni.

“Ka qene një eksperiencë e paharruar për mua. Kemi qenë pesë praktikantë, gjithsecili kemi shkuar me nga një gazetar profesional. Mua personalisht, herën e parë me ka rënë të bëj një temë për KEK-un, pastaj për Mitrovicën... Ka pasur raste kur kam shkuar edhe afër kufirit me Serbinë në Leposaviq, ku ne si praktikantë kemi pasur për detyrë që të bëjmë një raport të veçantë për temën e caktuar që e dërgonim tek redaktori i lajmeve, Mentor Shala, i cili i ka pëlqyer raportet e mia. Përveç kësaj jam angazhuar dhe i kam monitoruar nga afër edhe lajmet qendrore si dhe emisionet e ndryshme që janë realizuar në RTK. Vlen të cekët se shumë gazetarë edhe moderatorë të RTK-së janë treguar shumë të afërt me mua dhe kam krijuar raporte shumë të mira me ta, raporte të cilat i ruaj edhe tani që nuk jam më aty” - shprehet bashkëbiseduesja jonë.


Kaqusha duke intervistuar këngëtarin e estradës, Mahmut Feratin

Ajo është e mendimit se më vështiri është kur raporton drejtpërdrejt nga tereni: “Përgjegjësia është më e madhe atëherë kur raporton drejtpërdrejt nga terreni sepse aty çdo gjë shkon ‘live’”. Por, megjithatë, ajo është e mendimit se raportimi nga terreni është më shumë origjinal dhe nëse bëhen gabime publiku i pranon dhe i kupton ato.

Shoqërimi me këngëtarë të estradës

Kaqusha në jetën e saj private ka shumë miq, kolegë e bashkëpunëtorë. Ajo nuk ka zakon të dalë shumë sepse “nuk ka dëshirë të bie shumë në sy”. Kaqusha tregon se puna si prezantuese e ka bërë që të njihet dhe të krijojë shoqëri të reja me këngëtarë të estradës, e nganjëherë miqtë si për shaka i thonë se po rri vetëm me njerëz të famshëm dhe ke për t’u bërë edhe ti e famshme e s’ke për të na njohur.

“Rri shumë me këngëtarë të estradës sepse me njëfarë mënyre më imponohet pasi që kam mbrëmje të shpeshta me ta, bile shoqëria ime më thotë si n’hajgare se po rri shumë me këta të Estradës, tan’ kohën, po më thojnë se ki me u bo e famshme edhe ti dhe s’ki me na njoftë (hahaha). Nuk e di. Unë edhe si fëmijë kam qenë paksa më ndryshe se moshatarët e mi sepse fillova të punoj shumë e re dhe vetë puna ma ka imponuar që unë të rri me njerëz të zgjedhur. Jam një person që kam qejf të kem një shoqëri të mirë, një shoqëri që ia vlen. Për të qëndruar diku për qejf, rri në ato vende ku nuk bëhet shumë kallaballëk, rri nganjëherë për hatër të shoqërisë, mirëpo këto raste janë shume të rralla, sepse Gjilani është shumë vend i vogël, njeriu bie shumë në sy, e unë si një personalitet shumë i vogël kam dashur ta ruaj atë. Shumicën e kohës shkoj ne disa vende më të qeta ku ndjehem mirë dhe më pëlqen ushqimi te “Bojana”, te “Planeti”, por shkoj edhe në disa kafene që janë paksa më të qeta se këto të tjerat dhe zakonisht dal me motrën Lolën dhe shoqen Blertën. Këto janë disa nga vendet që frekuentoj në Gjilan, kurse këtu në Prishtinë kam shoqërinë e fakultetit, kam një shoqe me



të cilën rri vazhdimisht, Edonën, kurse tjerët i kam vetëm kolegë. Vendet që rri në Prishtinë janë lokale të njerëzve që i njoh, si lokali “Intro”, kafeneja e kolegut tim Resul Sinani, “piceria Aurora”, në MPM e në ndonjë vend tjetër, por ka raste kur unë shkoj edhe në qeveri dhe në bufe pimë kafe me emnaken time Kaqusha Jashari, kuptohet kur është pak më e lirë prej angazhimeve që ka”.

Kaqusha ka bashkëpunim shumë të mirë edhe me produksionin “DEA”. Kur ka kohe shkon shpesh në diskotekën e tyre në Prishtinë në mbrëmje të ndryshme që organizohen, zakonisht kur ka mbrëmje me këngëtarin Sinan Vllasaliu, me të cilin ka raporte shumë të mira.

Fakulteti...

Kaqusha është studente e gazetarisë në universitetin AAB. Ajo thotë se e ka zgjedhur këtë universitet për shkak kushteve dhe ligjëruesve:


“Në AAB i kemi kushtet shumë të mira, kemi profesorë shumë të mirë, si Adi Krastën, Rexhep Osmanin, Luan Dakën, Mimoza Dokon dhe profesorë të tjerë të cilët i çmoj shumë, si Ibrahim Berisha, e të tjerë”.

Kaqusha është e mendimit se çdo i ri duhet ta ketë personalitetin e vet dhe të mos i imitojë të tjerët. “Mos e merr personalitetin e tjetrit e t’i humbasësh vlerat e tua sepse vazhdimisht e dëmton dhe i bën padrejtësi vetes. Përmbaju realitetit dhe kualitetit tënd” – është mesazhi që Kaqusha ua drejton bashkëmoshatarëve të saj dhe lexuesve të revistës “Paqja”.

Të shpresojmë që Kaqusha të ketë në vazhdim edhe më shumë suksese në jetën e saj, por gjithashtu urojmë që të ketë njerëz të vullnetit të mirë dhe t’i nxjerrin në pah talentet e rinj dhe njerëzit që kanë elan dhe vullnet për punë, jo vetëm në gazetari, por edhe në fushat e tjera të shkencës dhe edukimit, sepse Kosova ka mjaft të tillë. ■

Energjia, rol thelbësor për zhvillim ekonomik

Energjetika, përkatësisht zhvillimi i sektorit të energjisë, ka një vend themelor, duke ditur rolin e energjisë si një resurs i pazëvendësueshëm në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit tonë.



Sead UJKANI

Pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, mbetet detyrë e institucioneve ndërtimi i një shteti të qëndrueshëm dhe forcimi i tij drejt prosperitetit afatgjatë.

Natyrisht, në tërë këtë proces, sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe afatgjatë ka rëndësinë e vet të posaçme. Është evident fakti se arritja e një qëllimi të tillë kërkon angazhimin e të gjithë strukturave relevante që, në mënyrë direkte apo indirekte, mund të kontribuojnë në realizimin e këtij qëllimi. Identifikimi, përkatësisht përzgjedhja e lëmenjve të cilat janë prioritare si dhe angazhimi në përmirësimin e tyre do të ishin thelbësore në tërë rrugën dhe strategjinë afatgjatë drejt stabilitetit dhe prosperitetit të Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, në tërë grumbullin e lëmenjve që gëzojnë prioritet për angazhimin e të gjithë instancave përkatëse, energjetika, përkatësisht zhvillimi i sektorit të energjisë, ka një vend themelor, duke ditur rolin e energjisë si një resurs i pazëvendësueshëm në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit tonë.

Më shumë se 1 miliardë euro janë investuar në KEK

Rëndësia e zhvillimit të këtij sektori rritet edhe më shumë kur marrim parasysh rezervat e mëdha të thëngjillit dhe linjitit që ka Republika e Kosovës, si burime kryesore të prodhimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm se, në përgjithësi, sektori i energjisë paraqet njërin ndër sektorët kryesorë në të cilin ka qenë e përqendruar ekonomia e Kosovës me vite, mirëpo periudha e izolimit të paraluftës, amortizimi i rrjetit si dhe keqmenaxhimet e shumta në tranzicionin e pasluftës kanë bërë të mundur që KEK-u, nga katalizatori i zhvillimit ekonomik, të kthehet në "harxhuesin" më të madh gjatë gjithë këtyre viteve.

Nga përfundimi i luftës, KEK-u ka thithur investime në vlerë prej më shumë se 1 miliardë euro dhe, në përgjithësi, përveç disa përmirësime minore, Republika e Kosovës vazhdon të vuajë nga gjendja kritike e furnizimit me energji elektrike.

Në një publikim të bërë nga UNDP-ja, lidhur me atë se ku janë shpenzuar paratë e investuara ne KEK, vlerësohet së një pjesë e madhe e tyre janë përdorur për riparimet në Termocentralin "Kosova B" si dhe për importimin e energjisë elektrike, ndërsa pjesa tjetër për rehabilitimin e blloqeve të dy termocentraleve, rënia e të cilëve nga sistemi pa paralajmërim tashmë është bërë rutinë, efekti kryesor negativ i të cilëve po bie mbi qytetarët e Republikës së Kosovës.

Një problem madhor, me të cilin është përballur sistemi i energjisë së vendit tonë, është edhe humbja e madhe që e ka karakterizuar këtë sistem gjatë këtyre viteve. Amortizimi i rrjetit, problemet teknike të orëmatësve, pagesa e ulët e faturave dhe, sigurisht, lidhjet jolegjitime në rrjetet e distribucionit nga qytetarë jo të ndershëm, janë identifikuar si shkaktarë kryesorë të humbjeve të tilla, vlerësohet ne këtë publikim.

> Në një hulumtim të bërë nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest" me pronarë dhe menaxherë të ndërmarrjeve, rreth 60 % e tyre konsiderojnë se afarizmi i tyre është keqësuar ose ka stagnuar pa shënuar asnjë rritje nga viti paraprak. Si faktor kryesor ata kanë identifikuar mungesën e furnizimit cilësor me energji elektrike.

Energjia dhe zhvillimi i sektorit privat

Një nga shtyllat kryesore, në të cilën pritet të mbështet zhvillimi ekonomik i vendit tonë në vitet e ardhshme, është zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Natyrisht, një zhvillim adekuat i tyre varet në masë të madhe nga mjedisi që do u ofrohet ndërmarrësve për promovimin e ideve të tyre. Në këtë kontekst, mungesa e furnizimit të duhur me energji elektrike dhe problemet që janë evidente në vendit tonë, sa i përket sistemit energjetik, janë shumë domethënëse në themelimin dhe funksionimin e mirëfilltë të bizneseve. Ofrimi i kushteve të mira për furnizim me energji elektrike do të këtë efektin e vet edhe në investimet e huaja të drejtpërdrejta në vendin tonë, investime të cilat, në këtë fazë në të cilën gjendet vendi ynë, janë më se të nevojshme.

Ndërtimi i Termocentralit "Kosova C"

Duke marrë parasysh gjendjen kritike të energjisë me të cilën po përballet në mënyrë të vazhdueshme vendi ynë, MEM në koordinim me partnerët ndërkombëtarë ka hartuar planin për ndërtimin e Termocentralit "Kosova C", në mënyrë që të sigurohet një furnizim cilësor dhe i qëndrueshtëm me energji elektrike, si faktor i rëndësishëm në drejtim të stabilitetit ekonomik të vendit. Ndërtimin e këtij termocentrali e ka vënë qëllim si qëllim të saj edhe Qeveria e Kosovës. Në programin e saj qeverisë gjatë mandatit 2008-2011 theksohet: "Procesi i ndërtimit të Termocentralit "Kosova C" do të jetë synim i Qeverisë për zgjidhjen e çështjes së furnizimit me energji elektrike të Kosovës. Projekti do të përcjellë dinamikën kohore të vendosur me asistencë teknike nga Banka Botërore, AER dhe USAID". ■

> Projektet për sektorin e energjetikës pritet të zënë një vend të rëndësishëm edhe në Konferencën e Donatorëve për Republikën e Kosovës që do të mbahet në fillim të muajit korrik nën organizimin e Komisionit Evropian. Në këtë kontekst, mbarëvajtja e mirëfilltë e kësaj konference dhe përfitimet e duhura, në përgjithësi, për të gjitha lëmenjtë dhe, në veçanti, për zhvillimin e sektorit të energjisë do të ishin thelbësore për tërë procesin e zhvillimit të gjithmbarshëm të Republikës së Kosovës.

"Lideri i madh" i mazohizmit politik

Instalimi i frikës në përmasa të gjera dhe mbyllja e gojës kundërshtarëve politikë me tytën e armës, është elementi i parë i një ideologjie fashiste, gjithmonë dhe gjithkund. Përshëndetjet në stilin fashist, si ajo që u pa në billbordat impozant të Menduh Thaçit, vijnë menjëherë si hap logjik i promovimit të "liderit të madh".

Milazim Krasniqi

Pasojat e vërteta të zgjedhjeve parlamentare të dhunuara nga bandat e organizuara të dy partive politike shqiptare në Maqedoni, veçmas të asaj që është pjesë e koalicionit qeveritar, do të ndihen dhe do të shihen në të ardhmen. Njëra nga pasojat më direkte do të jetë defaktorizimi i shqiptarëve në atë republikë dhe perceptimi i tyre si shkaktar i ngadalësimit të integrimit të Maqedonisë në strukturat evropiane dhe atlantike. Në këtë kontekst, mund të harrohet shpejt obstruksioni i Greqisë ndaj Maqedonisë dhe të mbahet mend vetëm se shqiptarët me primitivizmin dhe me banditizmin e tyre politik, u bënë shkaktarë të mbetjes së Maqedonisë jashtë procesit integrues euro-atlantik. Ky perceptim mund ta rritë armiqësinë e maqedonasve ndaj shqiptarëve, mund të nxitë disa politika edhe më restriktive ndaj bizneseve të tyre dhe mund të rikthejë idenë e para vitit 2001, se shteti funksionon shumë më mirë pa shqiptarët.

Nëse ndodhin këto gjëra, atëherë shqiptarët në Maqedoni do të kenë vetëm dy rrugë: ose rebelimin e sërishëm, ose nënshtrimin e pakthyeshëm ndaj dominimit të popullit shumicë. Pra, që të dyja opsionet do të jenë të rrezikshme dhe të dëmshme.

Ndërsa, në kontekstin mbarëshqiptar, shqiptarët e Maqedonisë do të mund të shikohen si "dele e zezë", që nuk është aftësuar për të respektuar një standard elementar të demokracisë: respektimin e votës së lirë.

Nga reagimet e shpejta të faktorëve ndërkombëtarë ndaj dhunimit të votës së qytetarëve në viset shqiptare në Maqedoni, bëhet e qartë se nuk do të pritet gjatë për të parë pasojat e këtij banditizmi politik. Deklarata shokuese e ambasadores amerikane në Shkup, Xhili Milovanoviq, se u evitua lufta civile, me siguri që do të shoqërohet edhe me masa të shpejta të identifikimit të fajtorëve. Nëse shqiptarët e Maqedonisë e sollën veten në prag të konfliktit civil, përgjegjësit duhet të identifikohen dhe të merren në përgjegjësi urgjente, në mënyrë që të mos kenë mundësi të vazhdojnë planet e tyre shkatërrimtare. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kapacitete të mjaftueshme diplomatike për t'i detyruar rebelët që të dorëzojnë armët. Ndoshta fillimisht, ato armë u shkrepën për të kremtuar fitoren e rreme, sepse fitoren e shpall komisioni shtetëror i zgjedhjeve e jo bandat e armatosura dhe shpallja e fitores në atë mënyrë dhe me ato breshëri është element i grushtit të shtetit.

Edhe reagimet e zyrtarëve nga Kosova dhe nga Shqipëria nuk lënë dilema sa i takon distancimit nga banditizmi politik që përshkoi zgjedhjet parlamentare në viset shqiptare në Maqedoni. Por, në këtë mes, duhet të shikohet se a ka pasur motivime nga segmente të caktuara politike e parapolitike nga Kosova ose nga Shqipëria, për atë egërsim politik të Partisë Demokratike Shqiptare. Bile edhe më shumë: a mos ka forca në këto dy vende, që presin ta aplikojnë modelin e PDSH-së, nëse ai kalon pa ferrë në këmbë?



Megjithatë, mbetet një faktor për ta thënë fjalën e vet në këtë situatë: qytetarët shqiptarë në Maqedoni. Ata duhet ta mposhtin frikën dhe duhet ta marrin përgjegjësinë për zgjedhjen e përfaqësuesve të vet. Për faktin se vullneti i tyre politik është dhunuar në mënyrë sistematike, tash sa vite, ata janë edhe vetë fajtorë. Dhënia e votës politikanëve që flasin e veprojnë kundër vlerave të atij komuniteti, është një hipokrizi morale e vetë atyre. Nëse dikush të fyen e të pështyn në fytyrë, ta shan besimin fetar e historinë dhe prapë e voton, faji nuk është vetëm i atij si dhunues, po edhe i të dhunuarit, që manifeston prirje mazohiste. Këtë prirje të një pjese të elektoratit shqiptar në Maqedoni e kam identifikuar dhe e kam denoncuar para disa viteve, në vorbullën e një polemike me liderin e tashëm të PDSH-së. Frika që kam parë në atë kohë në sytë e shumë miqve të mi në Maqedoni, për faktin se isha ngatërruar në polemikë me Menduh Thaçin, ma ka bërë të qartë se potencialet e dhunës së tij e të partisë së tij janë shumë më largvajtëse. Kam pasur raste që miqtë e mi në Maqedoni, nuk kanë guxuar as ta marrin në dorë librin tim "E vërteta e Islamit ndër shqiptarë", ku pata botuar polemikat e mia me liderin e PDSH-së dhe me kollankusurin e "intelektualëve"- komesarë të partisë së tij, përfshirë edhe pseudoideologun tinëzar, Arbën Xhaferin. Instalimi i frikës në përmasa të gjera dhe mbyllja e gojës kundërshtarëve politikë me tytën e armës, është elementi i parë i një ideologjie fashiste, gjithmonë dhe gjithkund. Përshëndetjet në stilin fashist, si ajo që u pa në billbordat impozant të Menduh Thaçit, vijnë menjëherë si hap logjik i promovimit të "liderit të madh".

Nëse në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve në vendvotimet e dhunuara nuk sigurohet respektimi i vullnetit të qytetarëve dhe nëse ata nuk lirohen nga frika dhe nga terrori, atëherë Maqedonia do të mund të bëhet "vrimë e zezë" në rajon sa i përket dhunimit të demokracisë. Nëse përsëritet edhe njëherë dhuna, atëherë pasojat që u evidencuan në fillim të këtij teksti, do të jenë shumëfish më të rënda. Jo vetëm për shqiptarët e Maqedonisë, po edhe për Kosovën dhe për Shqipërinë. ■



Nga retrospektiva në ngritje të ndërgjegjes historike apo rifreskimit të trurit shqiptar

Malësia e Gollakut të Bujanovcit po

Ka disa vjet që Malësia e Gollakut të Bujanovcit, gjegjësisht me fshatrat Zarbincë, Suharrnë, Novosellë, Pribovc, Qarr dhe Ramnabuqë, ka mbetur gati pa asnjë element shqiptar. Ka disa vjet që mediat dhe institucionet e kanë mbuluar me heshtje "mortore" këtë proces të deshqiptarizimit të këtyre trojeve....



Sabri HALILI

Në Kosovë jemi mësuar të dëgjojmë të flitet për shpërngulje, për kthime në vatrat e tyre të etnive të ndryshme, sidomos të serbëve dhe komuniteteve të tjera joshqiptare. Edhe pse shpërngulja nuk ka reshtur edhe për shqiptarët, në këtë rrafsh nuk dëgjohet të flitet asgjë. Ata janë shpërngulur dhe po shpërngulen nga Kosova, nga Kosova lindore dhe trojet e tjera etnike dhe askush nuk çan kokën për këtë, sikur të mos ndodhte asgjë. Më e turpshme është që as mediat e as institucionet nuk merren aq shumë me këto aspekte të rëndësishme të historisë sonë, që duket se për ne shqiptarët është e gjykuar që të përsëritet vazhdimisht.

Ndoshta individët kënaqen me moton që dëgjohet aq shpesh në popull, se "ka boll shqiptarë" dhe nuk është aq me rëndësi edhe nëse shpërngulen.

Sipas kësaj logjike, gjëja e rëndësishme për të cilën ne duhet të preokupohemi në vazhdimësi është shpërngulja e serbëve dhe të tjerëve nga Kosova. Për shkak të kësaj as që mendohet për një aspekt tepër me rëndësi historike e politike, për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore, nga Kosova Lindore, që tashmë është një proces pothuajse i përfunduar.

Cilat janë fshatrat e Malësisë të cilat ngjajnë si fantazmë?

Në këngët popullore, patriotike, por edhe në historinë më të re, kemi dëgjuar dhe lexuar shumë për "Mollën e kuqe" dhe për trojet shqiptare që dikur ishin plot me shqiptarë në "zemër" të Serbisë. Vazhdojmë të kënaqemi me melosin e bukur e patriotik dhe me përkujtimet se një kohë na ishte.... ç'na ishte. Megjithatë, këto mbeten vetëm këngë dhe dëshira të bukura që një ditë shqiptarët do të kthehen në këto troje. Në anën tjetër, nuk bëjmë asgjë për ruajtjen e trojeve të tjera që po përjetojnë të njëjtin fat si ato nga "Molla e Kuqe, gjegjësisht, Toplica e Nishit, por me një proces fare tjetër, pa zhurmë dhe pa dhunë.

Ka disa vjet që Malësia e Gollakut të Bujanovcit, gjegjësisht me fshatrat Zarbincë, Suharrnë, Novosellë, Pribovc, Qarr dhe Ramnabuqë, ka mbetur gati pa asnjë element shqiptar. Ka disa vjet që mediat dhe institucionet kanë mbuluar me heshtje "mortore" këtë proces të deshqiptarizimit të këtyre trojeve. Ka disa vjet që këto troje u përngjajnë fantazmave dhe tregimeve të gjyshërve dhe baballarëve tanë se "dikur trojet që dalin pak për tej këtyre fshatrave na ishin plot me shqiptarë, ndërsa shkiet na larguan me dhunë".

Ku shtrihen këto troje shqiptare në sferën gjeografike?

Zarbinca, Probovci, Qarri dhe Ramnabuqa kufizohen me malësinë e Kamenicës, ndërsa Suharrna dhe Novo Sella i afrohen krejtësisht Vrajës. Ndarja e tyre nga Kosova është bërë për shkaqe politike, sepse nuk është logjike një ndarje e tillë gjeografike ku disa fshatra janë shumë afër Vrajës dhe të tjerat kufi-





...o përjeton fatin e Toplicës së Nishit

zohen me Malësinë e Kamenicës e bien në Komunën e Bujanovcit, që s'kanë asnjë lidhje as gjeografike e as të tjera. Të gjitha këto fshatra kanë qenë etnikisht të pastra shqiptare deri para 8 vjetësh, sepse aktualisht në këto fshatra nuk banon gati askush. Banorët e këtyre fshatrave, që deri dje kishin plane dhe synime të mëdha për të jetuar në trojet e tyre, gjë që faktohet me ndërtimet e shtëpive dhe objekteve të tjera përcjellëse që ishin bërë me vite të tëra, tashmë janë akomoduar në pjesë të ndryshme të Kosovës, ndërsa ëndrrat e tyre për ndërtimin e jetës në trojet e tyre të lindjes mbetën vetëm ëndrra.

Cilat ishin shkaqet e shpërnguljes?

Shkaqet që çuan deri te shpërngulja masive e banorëve të Malësisë janë të shumta, por shkaku më kryesor është ai i ndjenjës së pasigurisë, gjegjësisht shkaku psikologjik.



Procesi i shpërnguljes ka filluar që nga vitet 60-ta, por njerëzit janë larguar për shkaqe ekonomike dhe ekzistenciale. Gjatë luftës së fundit të UÇMB-së me forcat serbe, ku këto fshatra ishin bazë e fuqishme e forcave shqiptare, filloi shpërngulja masive për shkak të frikës nga pasojat eventuale. Të gjithë të shpërngulurit ishin vendosur në komunën e Gjilanit dhe të Kamenicës dhe një numër i vogël shkuan në Bujanovc. Ata u vendosën kush te të afërmit, kush kishte gjetur ndonjë banesë ose shtëpi të boshatisur, kryesisht të serbëve e romëve, por ata që ishin të fuqishëm ekonomikisht investuan për krijimin e vendbanimit të ri.

Ata që e udhëhoqën luftën dhe u kujdesën që të nënshkruajnë paqen, më vonë zunë pozita të ndryshme në shoqërinë e Luginës..., ose nuk e patën idenë për pasojat, ose nuk menduan fare për një gjë të tillë. Të tillët edhe sot nuk çajnë kokën për ata që nuk janë më banorë të këtyre trojeve, e as që e dinë se ku janë dhe nuk e kanë idenë, ndoshta, se ku gjenden këto fshatra të cilat paraqesin një pasuri të pamatshme për shoqërinë shqiptare në tërësi.

Ku dhe si jetojnë banorët e Malësisë së Gollakut?

E sot, ku janë banorët e Malësisë së Gollakut të Bujanovcit? Kjo është pyetja për të cilën nuk çan kokën askush nga udhëheqësit, as në Kosovë, e as në Preshevë e Bujanovc. Me siguri se shumë prej tyre as që kanë ditur për këtë proces, e si ta dinë se ku dhe si jetojnë këta banorë tashmë me një vendbanim të ri. Ata sot mund t'i gjesh kudo dhe askund. Jeta e tyre është gjithfarë, varësisht se si ka mundur çdonjëri të gjendet në atë gjendje kaosi dhe anarkie. Numri më i madh i tyre jetojnë në komunën e Gjilanit, por ka edhe prej tyre që jetojnë në komunën e Kamenicës. Disa janë vendosur me qira, disa kanë "huazuar" ndonjë shtëpi rome apo serbe, ata që kanë pasur mundësi ekonomike kanë ndërtuar shtëpi të reja dhe nuk e ndiejnë shumë mungesën e vendlindjes.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Paqësore të Konçulit, shumë organizata humanitare ofruan ndihmat e tyre për të mundësuar kthimin e banorëve në trojet e veta. Këto ndihma konsistonin në ushqim, veshmbathje, madje edhe në pajisje bujqësore dhe në kafshë shtëpiake. Të gjitha këto ndihma banorët i kanë marrë për një kohë të gjatë, por asnjëri prej tyre nuk ka vendosur që të kthehet. Kjo ka ndodhur për shumë arsye, por para së gjithash nga frika dhe pasiguria. Po ashtu, ka munguar një fushatë informimi i institucioneve përkatëse në Bujanovc e Preshevë, por edhe në Kosovë.

Edhe sot duhet të veprohet deri sa nuk është bërë tepër vonë. Atje mund të jetohet në paqe, askush nuk e pengon askënd. Tashti nuk kemi më arsyetime për dhunë, presion.... ■

Procesi i Akreditimit në Institucionet private të Arsimit të Lartë në Kosovë

Universitetet private të Kosovës në Ilu

Akreditimi ka filluar më 19 maj, ndërsa më 30 qershor do të dihet saktë se cila prej institucion licencuar mund t'i ofrojnë programet e tyre për studentët e interesuar nga 10 deri më 15 korrik



Gëzim QERIMI

Tridhjetë institucione private të arsimit të lartë kanë konfirmuar se janë të gatshme t'i nënshtrohen procesit të akreditimit. Këto institucione kanë dorëzuar në Ministrinë e Arsimit dokumentacionin për akreditim dhe pastaj për rilicencim. Ndërkohë, sipas datave të përcaktuara nga ministria, akreditimi ka filluar më 19 maj, ndërsa më 30 qershor do të dihet saktë se cila prej institucioneve do ta fitojë këtë të drejtë nga Këshilli Britanik për Akreditim.

Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës ka paralajmëruar se asnjë institucion nuk mund të licencohet nëse nuk ka kaluar nëpër procesin e akreditimit. Nëse këto institucione janë të interesuara të rilicencohen, ato duhet të përfshihen në procesin e akreditimit. Ky vendim bazohet në legjislacionin e vitit 2003, i cili nuk është zbatuar që prej pesë vjetësh në Kosovë, ndërsa tash ministria e arsimit është duke bërë përpjekje që ta arrijë këtë për tre muaj. Sipas gjithë kësaj anomalie, vlen të theksohet që Kosova ka dështuar që pesë vjet në arsimin e lartë. Pesë vjet janë dhënë licenca pa kurrfarë kriteresh, andaj veprimet e fundit të MASHT-it dhe ministrit Enver Hoxhaj rreth procesit të akreditimit janë veprime të domosdoshme të cilat mund t'i thonë stop veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, të cilat më shumë prodhojnë kuantitet se sa kualitet.

Për ta riparuar këtë gjendje në arsimin e lartë privat në Kosovë, Ministria e Arsimit ka emëruar një institut britanik ndërkombëtar për akreditim, i cili është nga më prestigjiozët për të kryer një proces të tillë.

Procesi i akreditimit duhet të përfundojë deri në fund të qershorit, ndërsa në fillim të korrikut do të mblidhet Komisioni, i cili do të vendosë për dhënien ose mosdhënien e licencave. Mirëpo, më e rëndësishmja është se edhe pas licencimit, ekspertët britanikë të akreditimit do t'i rikthehen sërish edhe atyre institucioneve që i kanë vizituar më parë, në mënyrë që të merren sa më shumë informata për të konstatuar gjendjen e vazhdueshme në institucionet private të arsimit të lartë në Kosovë.

Universiteti duhet të ketë jo më pak se 3 mijë studentë

Ligji parasheh që një institucion për t'u quajtur universitet duhet të ketë jo më pak se 3 mijë studentë dhe jo më pak se 6 fakultete, kritere që do t'ua heqin këtë "privilegj" shumë universiteteve.

Procesi i akreditimit të universiteteve është i rëndësishëm sepse ai do të shërbejë si bazë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, në përputhje me ligjin, të formojë një komision që do të sigurojë dhënien e licencave. Dhënia e licencave nuk është vendim i ministrit, por, sipas ligjit, është vendim i një komisioni që jepet në bazë të raportit të akreditimit.

MASHT-i i vendosur që ta respektojë ligjin

Këshilli Britanik për Akreditim ka ofruar për secilin institucion të arsimit të lartë nga një pyetësor. Pyetësori i plotësuar përfshin strukturën, procesin, procedurat e tyre, pastaj i referohet edhe stafit mësimdhënës që kanë universitetet, organizimit të programeve mësimore, mënyrës së organizimit të provimeve, infrastrukturës, financave, shënimeve për studentë etj.

Mirëpo, nëse ministri Enver Hoxhaj e mban fjalën se në këtë drejtim do të respektohet vetëm ligji, shumë institucione të arsimit të lartë privat do të duhet ta ndërrojnë emrin. Ligji e përcakton shumë mirë se sa studentë duhet të ketë një institucion që të jetë universitet, sa një institucion që të jetë fakultet dhe çfarë karakteri duhet të ketë në punën e tij ditore një institut.

Ministri Hoxhaj gjatë tërë kohës ka thënë se nuk do të lëshojë asnjë licencë që bie në kundërshtim me ligjin, duke filluar që nga precizimi i saktë i emrit të secilit institucion.

Ligji parasheh që një institucion për



...upën e Këshillit Britanik për Akreditim

...neve do ta fitojë këtë të drejtë nga Këshilli Britanik për Akreditim. Bartësit e arsimit të lartë të ... – ka bërë të ditur MASHT-i.

t'u quajtur universitet duhet të ketë jo më pak se 3 mijë studentë dhe jo më pak se 6 fakultete, kritere që do t'ua heqin këtë "privilegj" shumë universiteteve. Por, si duket, MASHT-i është i vendosur që ta respektojë ligjin. Gjithashtu, Ministria e Arsimit është e interesuar që standardet e përcaktuara nga Këshilli Britanik për Akreditim, që janë standarde që përdoren edhe në universitetet e tjera me renome botërore, të aplikohen edhe në Kosovë. Duhet theksuar se Këshilli Britanik për Akreditimin e universiteteve ka bërë akreditimin e 240 bartësve të arsimit të lartë privat.

Standardet evropiane do të aplikohen edhe në Kosovë

Akreditimi në Evropë nuk është diçka e re, ajo funksionon që 15 vjet. Tani standardet evropiane do të aplikohen edhe në Kosovë. Procesi ka filluar me vlerësimin e performancës, cilësisë, standardeve dhe trajnimin e të gjithë universiteteve private dhe shtetërore për këtë proces shumë të rëndësishëm. Pastaj, institucionet do të bëjnë vetëvlerësimin e tyre, mirëpo, gjithmonë nën mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Akreditim – ka pohuar drejtoresha e kësaj agjencie, Prof. Dr. Ferdie Zhushi-Etemi.

Nëse cilësia e arsimimit nuk përmbush minimumin e standardeve evropiane, atëherë nuk do të ketë akreditim. Kjo është e nevojshme për të mbrojtur studentët që duan, që në fund të studimeve, të kenë certifikata-diploma apo thirrje akademike që do t'u pranohen ndërkombëtarisht. Ky duhet të jetë edhe qëllimi i akreditimit dhe rilicencimit.

Është në dobi të studentëve që cilësia të jetë në nivel ndërkombëtar, ashtu që diplomat të mund të pranohen ndërkombëtarisht, pra ato duhet të përmbushin njërin nga tri kushtet themelore të Deklaratës së Bolonjës, e ai është mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik".

Gjatë vitit 2008, synimi i secilit universitet privat duhet të jetë avancimi i performancës së institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, nëse dëshiron që të merren vërtet me arsimimin e gjeneratave të reja. Në të kundërtën, imazhi i universiteteve private do të jetë i barabartë me imazhin e kioskave që janë kudo nëpër rrugët e Kosovës dhe ofrojnë shërbime të ndryshme për qytetaret, por jo edhe arsimim. ■

UNIVERSITAR ...TORY ...SHTINË

Institucionet Private të Arsimit të Lartë që kanë aplikuar për licencë:

Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK); Universiteti Evropian në Kosovë (EUK); Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT); Universiteti i Prizrenit; Design Faktori; Kolegji Universitar "Victory"; Universiteti AAB; Akademia e Arteve; Fakulteti i Ekologjisë "Ekoman"; Instituti Katana; Kolegji Universitar i Ferizaj-it; Kolegji Universitar "Vizioni Evropian"; Instituti NIK Holding; Kolegji Universitar "Eurosport"; Fakulteti i Farmacisë ;Kolegji Universitar i Gjilanit; Universiteti Rezonanca ; Kolegji Universitar "Universum"; Kolegji Universitar "Amerikos"; Universiteti Ndërkombëtar i Prishtinës; Kolegji Universitar "Tempulli"; Universiteti Mbretëror "Iliria"; Universiteti "Riinvest"; Kolegji universitar "Fama"; Akademia Evropiane "Teuta"; Akademia "Evolucion"; Universiteti "Pjetër Budi"; Akademia Universitare "Shkencat e përparuara"; Universiteti "Dardania"; Kolegji Universitar i Biznesit; Akademia për teatër, film, TV dhe radio.



Punimi i titulluar "Kampi i refugjatëve", me të cilin grafisti nga Kosova Halim N. Mejzini zuri vendin e tretë në Ekspozitën botërore të pikturës dhe grafikës në Lessedra të Bullgarisë. Mejzini së bashku me austriakun Manfred Egger (vendi i parë) dhe japonezin Mitssu Sanpei (vendi i dytë), janë zgjedhur më të mirët në mesin e 600 artistëve nga 66 vende të botës.

Çfarë solli testi i maturës 2008?

Testi i dilemave

Rreth 60 për qind e pyetjeve ishin nga lëndët bazë, si: gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë angleze, etj., ndërsa 40 për qind nga lëndët e përafërta me drejtimet përkatëse të shkollimit të mesëm.



Fitim VELIU

Më 7 qershor, në mbarë Kosovën, u mbajt testi i maturës për vitin 2008. Këtij testi iu nënshtruan 22 mijë nxënës, përfshirë edhe komunitetet e tjera, përveç atij serb, që edhe këtë radhe e ka bojkotuar me arsyetimin se nuk e njeh legjitimitetin e institucioneve të Kosovës.

Provimi është mbajtur në të gjitha qendrat njëkohësisht dhe për administrimin e tij është përkujdesur MASHT-i, i cili kishte angazhuar mbi 1600 persona. Për sigurinë e mbarëvajtjes së këtij testimi janë angazhuar edhe pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës.

Rreth 60 për qind e pyetjeve ishin nga lëndët bazë, si: gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë angleze, etj., ndërsa 40 për qind nga lëndët e përafërta me drejtimet përkatëse të shkollimit të mesëm.

Testi ishte hartuar në konfidencialitet të plotë dhe ishte nën mbikëqyrje të policisë. Për dallim nga hera e kaluar, ku mbikëqyrës të testit ishin vendësit e së njëjtës shkollë, kësaj radhe ky test mbikëqyrej nga punonjësit e shkollës tjetër. Për maturantët ky test nuk ishte i vështirë për t'u kaluar, sepse ishte e mjaftueshme që të plotësohej saktë 50 % e testit. Megjithatë, kjo nuk ishte e mjaftueshme që nxënësit të ndiheshin komodë, sepse testi kishte në vete edhe vështirësi të cilat nuk kaluan lehtë.

Nxënësit ankohen për parregullsi

Edhe kësaj radhe moskoordinimi i punëve si duhet, lidhur me literaturën për shkollat e mesme, do t'u shkaktojë nxënësve mungesë pikësh në rezultat. Përbrenda këtij testi ishin hartuar disa pyetje nga lënda e gjeografisë për klasën e 12-të, por nxënësit shprehen se nga kjo lëndë nuk kishin pasur tekste dhe ishin detyruar të përdornin tekstet e klasës së 13. Nga kjo lëndë ishin 13 % e pyetjeve.



Nxënësit kanë pasur vërejtje edhe për pyetjet e testit në anglisht, sepse ato nuk korrespondonin me njohuritë të cilat i kishin mësuar në shkollë dhe po ashtu kishin vërejtur edhe gabime teknike, pasi një pyetje përmbante dy përgjigje të njëjta. Nxënësi Fatmir Gashi, nga gjimnazi "Hamëz Jashari", është shprehur se këto gabime mund të reflektohen në rezultatin përfundimtar të testit.

Nga ana tjetër, inspektori i arsimit, Zijadin Gashi, është shprehur se testi ka qenë plotësisht në rregull. Sipas tij, nxënësit nuk kanë qenë të koncentruar sa duhet dhe kjo ka bërë që ata të kenë dilema në dhënien e përgjigjeve. Po ashtu, Gashi mohon të ketë pasur dy përgjigje të njëjta.

Nazmi Cakaj, anëtar i komisionit nga MASHT-i, ka theksuar se çdo gjë ka shkuar mirë. Ai ka shprehur brengën se këtë vit ka pasur pak nxënës të arsimit joformal nga shkollat profesionale.

Shikuar në përgjithësi, këtë vit, duket se diçka ka qenë më mirë se vitet e tjera, por hartimi i testeve duhet të bëhet nga njerëz profesionistë të lëmive, në mënyrë që të mos bëhen gabime teknike të këtij lloji që hetuan nxënësit.

Duhet theksuar se maturantëve që i janë nënshtruar testit, për të vazhduar shkollimin e tyre më tutje, krahas 50 % të pikëve të domosdoshme në test, ju nevojitet edhe suksesi i arritur gjatë shkollimit të mesëm që vlerësohet deri në 20 % dhe testi pranues në fakultet, i cili në disa fakultete madje do të jetë përcaktues. ■



Organizohet edicioni i tetë i Universitetit Veror të Prishtinës (UVP)

400 studentë vendorë e ndërkombëtarë në UVP

Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, pjesëmarrësit do të marrin certifikata sipas Sistemit Evropian për Transfer të Kredive (ECTS) të transferueshme në Universitetin e Prishtinës dhe institucionet ndërkombëtare



Shehide QERIMI LUSHTAKU

Nga data 14 korrik deri më 1 gusht 2008, Universiteti i Prishtinës do të organizojë edicionin e tetë të Universitetit Veror të Prishtinës (UVP) në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, në Prishtinë.

UVP është projekti më i madh ndërkombëtar që synon ta ngrejë nivelin e ndërkombëtarizimit të UP-së dhe të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të arsimit në Kosovë dhe rajon. Universiteti Veror i Prishtinës ofron mundësi unike për zgjerimin e njohurive dhe aftësive në fusha të ndryshme të studimit, duke përfituar nga metodologjitë më të reja të ligjërimit si dhe duke u kënaqur me një atmosferë ndërkombëtare. Ky projekt është iniciativë e përbashkët e Universitetit të Prishtinës dhe e Shoqatës për Trajnim Akademik - SPARK (ish-ATA).

Universiteti Veror i Prishtinës financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Pro Credit Bank, OSBE-ja, Cultural Heritage Without Borders si dhe Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Ne programin e sivjetmë do të organizohen pesëmbëdhjetë kurse, nga fusha e shkencave sociale, juridike, ekonomike, teknike, e inxhinierisë dhe kulturës fizike. Në secilin kurs do të ligjërojë një profesor ndërkombëtar vizitor dhe një profesor vendor. Do të marrin pjesë më shumë se pesëmbëdhjetë ligjërues me përvojë nga shtete të ndryshme, si: SHBA, Austria, Gjermania, Turqia, Spanja, Finlanda, etj. Të gjithë profesorët vizitorë marrin pjesë vullnetarisht dhe mbajnë ligjërata falas në Universitetin Veror të Prishtinës.

Literatura që do të përdoret në UVP-2008

Kryesisht secili kurs do të ketë librin e vet të kursit dhe materialet për lexim, të cilat përmbajnë ese, kapituj, etj. Materiali për lexim do të ketë rreth 100 faqe. Pos literaturës së duhur, për kurs, do të ofrohet edhe lista për lexim fakultativ (joformal) dhe materiale shtesë.

Universiteti Veror i Prishtinës (UVP) do të sigurojë për pjesëmarrësit tërë materialin lexues në fillim të çdo kursi.

Këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar, të gjitha kurset do të zhvillohen në gjuhën angleze, duke ofruar kështu mundësi për aplikimin e kritereve ndërkombëtare të organizimit të kurseve dhe përdorimit të literaturës më bashkëkohore ndërkombëtare. Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, pjesëmarrësit do të marrin certifikata sipas Sistemit Evropian për Transfer të Kredive (ECTS), të transferueshme në Universitetin e Prishtinës dhe institucionet ndërkombëtare.

> I dedikuar për mësim dhe hulumtim sipas vlerave e sistemeve perëndimore, Universiteti i Prishtinës po bën hapa të guximshëm për të shkuar drejt Procesit të Bolonjës. Një dëshmi e fortë për këtë është edhe organizimi i Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës 2008 dhe vlen të theksohet se ky organizim tanimë është bërë tradicional, pasi organizohet që tetë vite radhazi.

Këtë vit është planifikuar të pranohen më se katërqind studentë vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, pjesëmarrja e të cilëve në kurset e UVP 2008 do të jetë falas. UVP 2008 do t'u ndajë për pjesëmarrje bursa të gjithë studentëve nga shtetet fqinje dhe të rajonit.

Përveç shumëllojshmërisë së kurseve dy-tre javore, programi i Universitetit Veror të Prishtinës do të përfshijë edhe forume publike me mysafirë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, duke ofruar platformë për diskutim publik në fusha të ndashme. Të gjithë pjesëmarrësve të UVP-se do t`u ofrohet edhe program shoqëror dhe rekreativ, duke përfshirë ekskursionet e ndryshme, tubimet shoqërore dhe ngjarjet nga jeta kulturore. Informimi për forume dhe ngjarje të tjera do të publikohet me rastin e fillimit të UVP-së. ■


Universiteti i Prishtinës
Universiteti Veror i Prishtinës
Fakulteti Juridik, Kati IV
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: +38138246750
Fax: +38138244183
e-mail: uvp@uni-pr.edu
Web: www.uni-pr.edu

Universiteti 8
14 Korrik - 01 Gusht 2008
Veror
Ndërkombëtar
i Prishtinës
Afati i fundit për aplikim:
21Maj 2008

SPARK Amsterdam
Linnaeusstraat 35 F
1093 EE Amsterdam
The Netherlands
Phone: +31.20.5682088
Fax: + 31.20.5682099
Email: spark@spark-online.org
Web: www.spark-online.org

Agjensit kryesor lëvizës të globalizimit



Dr. Fadil MALOKU

Sipas shumë analizave të gjertanishme teorike dhe empirike, promotorët kryesorë të procesit të globalizimit u takojnë diskurseve që kanë të bëjnë me Kompanitë Transnacionale (KTN); Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF).


Kompanitë Transnacionale Ndërkombëtare (KTN)

Ndër elementët qenësorë pa të cilët as që mund të paramendohet procesi i globalizimit janë padyshim kompanitë e mëdha transnacionale, për të cilat flitet shpesh se mund të konsiderohen lirisht edhe shtete në hije të vendeve të zhvilluara, duke mos i përjashtuar këtu as SHBA-në. Kompanitë apo korporatat e para multinacionale, që quhen kështu për shkak se ato prej kohësh i kanë tejkaluar barrierat e kufijve, kanë lindur për herë të parë diku nga shek. i XIX-të.

Imperativi kryesor i KTN-ve, sipas shumicës së sociologëve, është orientimi i tyre total nga zhvillimi i faktorit tekniko-teknologjik, sigurimi i lëndës së parë për prodhimet e veta në tregjet e jashtme, apo e ashtuquajtura periferi, racionalizimi i prodhimeve përmes bartjes së tyre në vendet apo shtetet të cilat kanë në mënyrë të dukshme shpenzime më të vogla sesa në vendet prej nga vijnë KTN-të, krijimi i filialeve të reja nëpër mbarë botën, si dhe maksimalizimi i fuqisë punëtore në nivele standarde. Ekspansionin e tyre më të lartë, këto kompani, e kanë shënuar sidomos në vitet e '60-ta, kurse shekulli ynë thuhet se i ka thyer të gjitha rekordet. Ngaqë këtu hyjnë padyshim tregjet e vendeve postkomuniste të cilat mundësuan jashtëzakonisht rritjen e tyre, sa që ngandonjëherë thuhet në formë gjysmë metafore se disa prej tyre janë shumë *(Revista javore "Java" (Revista Mikste MM), nr. 125, 9 dhjetor 2004 fq.3.)* më të forta se disa shtete me traditë të gjatë demokratike, kurse për të tjerat që u liruan prej ideologjisë komuniste as që diskutohet.

Disa autorë, njohës të mirë të natyrës së veprimit të tyre, siç janë bie fjala Ignacio Ramone, i krahasojnë figurativisht këto krijesa me "gjigantët me shumë ndërmarrje, por të varur nga një qendër e vetme". Shikuar realisht, kompanitë e mëdha transnacionale sot ushtrojnë pjesën më të madhe të prodhimit bruto të gjithmbarshëm botëror.

Po ashtu, është me rëndësi për t'u theksuar edhe një fakt tjetër i cili rekomandon rreziqet kur është



fjala për diskursin e demokracisë në këto procese të reja globale. Kështu, p.sh. neoliberalët si Fransis Fukujama (me hit veprën e tij "The ende of History and last man") mendojnë që socializmi i përmbysur dhe konservatorizmi sot për sot paraqesin ende një çerdhe antidemokratike.

Duhet thënë se diskursi globalist, i identifikuar përmes KTN-ve, nuk prodhon gjithnjë konotime negative. Në të vërtetë, akti i identifikimit të tij me p.sh. progresin tekniko-teknologjik, kuptohet nuk ka pretendime të zhveshë apo edhe të kontestojë identitetet kulturore apo ato kombëtare, por, përkundrazi, shgpreh afirmimin e këtyre veçantive. Po ashtu, është e kuptueshme që sot pjesa dërrmuese e këtyre kompanive transnacionale (sidomos në vendet postkomuniste), duke dashur të maksimalizojë profitin e tyre, ngandonjëherë "instrumentalizojnë dhe keqpërdorin grupe të ndryshme, apo edhe popuj të tërë, në favor të dinamikës së interesave të tyre globale në botë".

Në këtë kontekst, mendoj që është mirë të elaborohet edhe qëndrimi i një antiglobalisti të njohur, i quajtur Noam Chomsky, i cili në veprën e tij të njohur analitike: "What really like United States?", (Çfarë dëshiron në të vërtetë Amerika?) bën përpjekje të argumentojë "keqpërdorimin e fuqisë së teknologjisë ndërkombëtare nga ana e SHBA-ve", duke e identifikuar atë si "plaçkitje tipike që zhvillohet në interes të një grupi të vogël shtetesh dhe numri të madh kapitalistësh".

Chomsky, në të vërtetë me dioptrinë e tij të sofistikuar, mundohet të dëshmojë se në dikursin botëror tani dominojnë "fuqitë e rendit të ri botëror", ndikimi i të cilave reflektohet në shumicën e vendeve, e posaçërisht në Amerikën Latine, në Azi, Afrikë, etj. dhe të cilat kanë për qëllim imediat shkatërrimin e qeverive legale dhe instalimin e regjimeve vasale.

Chomsky më tej thotë se doktrina e Monros, që qe proklamuar në vitin 1823, sipas të cilës "Amerika u takon vetëm amerikanëve", dalëngadalë po shndërrohet në "Amerikanët kanë të drejtë të përzihen në gjithë globin"... Ekspertët e proceseve sociale, ngandonjëherë duke dashur të imponohen me konceptet e tyre, bëjnë gabime kur është fjala për dinamikat zhvillimore të procesit të globalizimit. Kështu psh. Xhyzepe Bofa e përshkruan në mënyrë shumë kritike dukurinë e dilemës rreth globalizimit si mit dhe realitet. Ai thotë që: "globalizimi është i pandalshëm, ngaqë ai as nuk mundet, e as nuk dëshiron të ndërpresë zgjerimin e teknologjisë informative, apo të mekanizmave komunikues. Ai, po ashtu, identifikon edhe pasojat negative të këtij procesi për zhvillimin e ekonomive botërore, duke aluduar në shkallën ekstreme të papunësisë, dal-



limet sociale, internacionalizimin e krimit të organizuar (lindjes së "ekonomisë së vërtetë kriminale në botë" dhe "ngritjen e kapitalit financiar"), lindjen e nacionalizmit, rishfaqjen e konflikteve të vjetra gjeostrategjike dhe të konflikteve në baza etnike, që patën për pasojë shkatërrimin e dy perandorive: asaj ruse dhe asaj jugosllave.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Sipas shumë burimeve, rolet kryesore të këtij institucioni, me përmasa dhe detyra planetare, janë:

-tendencat e promovimit të një bashkëpunimi dhe ndërmjetësimi global institucional financiar;

-intencat e ofrimit të ndihmës për të krijuar një ekuilibrim të tregtisë ndërkombëtare;

-promovimi dhe mbajtja e një niveli konstant të lartë të punësimit dhe të të ardhurave, me qëllim të ruajtjes së një ekonomie stabile dhe pa shtendosje të dukshme në marrëdhëniet ndërkombëtare;

-krijimin e parakushteve stabile për një jodiskriminim të valutave të shteteve të ndryshme nëpër botë; dhe,

-krijimin e paradispozitave për një sistem të vetëm të pagesës, ndërmjet partnerëve të ndryshëm rajonalë dhe subrajonalë, së bashku me proceset e ndryshme të cilat shkojnë në disfavor të një këmbimi multilateral në botë.

Një ndër ekonomistët më të mëdhenj të shekullit të kaluar (sipas shumicës së ekspertëve të ekonomisë botërore), profesori i njohur Jim Saxton, institucionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar e shquan si një ndër institucionet "më arrogante, më kontraproduktive dhe më destabilizuese" që ka mundur t'i ndodhë ndonjëherë botës së civilizuar (!), i cili në esencë "posedon më tepër kapital sesa lë përshtypje në pamje të parë në opinionin e gjerë ndërkombëtar".

Teknologjitë informative

Ajo çka më së tepërmi e karakterizon dhe e fuqizon si diskurs, që tashmë e ka pushtuar tërë globin tokësor, është padyshim progresi gjithnjë e më dinamik i faktorit tekniko-teknologjik, apo progresi i faktorit pothuajse kryesor që e stimuloi me aplikativitet masiv procesin e globalizimit.

Ky faktor apo agjent, në shek. e XIX-të (padyshim që identifikohej me përdorimin e makinës me avull, pastaj me përdorimin e motorit me ndezje të brendshme, të telegrafit, telefonit, mobilit, kompjuterit dhe internetit), bëri ndryshime të mëdha në jetët e njerëzve. Do të ishte me interes që, në këtë rast, të bëjmë disa krahasime të thjeshta. Kështu bie fjala, nëse për një telefonatë nga njëri cep i Londrës në cepin tjetër të Nju-Jorkut, në vitet e '60-ta, duhej të pagueje 60 $ gjithsej, kurse në vitet e '70-ta diku rreth 40 $, së fundi, në vitet 90-ta, vetëm 40 centë! Ose bie fjala, nëse për një kompjuter me perfomancë solide sot paguhen diku rreth 700 $, në vitet e '70-ta ai kushtonte 200.000 $, kurse në vitet '60-ta diku rreth 1.870.000 $.

Një dinamikë e tillë e zhvillimeve teknologjike ka bërë ndryshime rapide jo vetëm në jetën e njerëzve, por edhe në sferën më të rëndësishme, atë të ekonomisë. Është e nënkuptueshme që tërë këtë progres, jo vetëm ekonomik por edhe të mirëqenies së përgjithshme shoqërore, e udhëhoqi Organizata Botërore e Tregtisë.

Mirëpo, nëse do të dëshironim ta zbërthenim konceptin e teknologjisë informative, do të duhej t'i adresoheshim teknikës, përkatësisht teknologjisë së mjeteve integruese, gjegjësisht mikroçipave. Pra, thënë edhe më thjesht, me teknologji informative nënkuptojmë përdorimin masiv të teknikës llogaritëse dhe të asaj telekomunikative në përpunimin e të dhënave, si edhe tërë teknologjinë pasuese që ka ndihmuar në krijimin dhe menaxhimin e këtyre të arriturave në të gjitha sferat e jetës.

Fenomeni i internetit

Të gjithë sot jemi dëshmitarë të një revolucioni të vërtetë në sferën e komunikimit masiv i cili lirisht mund të thuhet se i tejkalon edhe suazat e imagjinatës fantastiko- shkencore. Dija tani është bërë një element shumë i rëndësishëm i prodhimit, ngaqë pa involvimin e saj është vështirë të paramendohet çdo konkurrim në cilëndo qoftë sferë të jetës.

Pra, kemi të bëjmë me një lloj revolucioni informativ, me të cilin prejudikohet "revolucioni i tretë industrial", i cili paraqet një hap tejet të rëndësishëm në revolucionarizimin e nevojave dhe kërkesave të njeriut në kohën e tanishme.

Revolucioni Industrial, në të vërtetë, paraqet një ndikim tejet të theksuar të teknologjive informative në të gjitha poret e jetës shoqërore. Zhvillimi tejet i madh i llogaritësve digjital dhe sidomos i mjeteve telekomunikative, krahas zhvillimit të transportit ndërkombëtar, është bartësi kryesor i procesit të globalizimit.

Prodhimet e revolucionit industrial, sikurse janë p.sh. satelitët, të cilët mundësojnë përcjelljen globale të programeve televizive në gjithë rruzullin tokësor, pastaj sistemet tejoqeanike kabllovike, të telefonit GSM, etj., janë baza themelore e zgjerimit të bashkëpunimit global dhe të ndikimit në sferën e ekonomisë, kulturës, informimit publik, etj. Ndërsa fenomeni i internetit, apo rrjeti botëror informativ, është krijuar si pasojë e lidhjeve më të vogla kompjuterike, që respektonin një protokoll të aranzhuar më parë (TCP/IP (Transfer Control Protocol/Internet Protokol).

Në të vërtetë, interneti për herë të parë u zhvillua si pasojë e decentralizimit të rrjeteve kompjuterike nga ana e ushtrisë Amerikane (ARPANËT), e cila edhe dha impulset e para për përparimin edhe të rrjeteve të tjera kompjuterike që ishin të centralizuara në këmbim të informative shkencore në Amerikë dhe Evropë.

Ideja mbi decentralizimin e rrjetit kompjuterik, ku një kompjuter apo disa të tillë do të mund t'i kontrollonin të gjitha të dhënat informative në të, ndoshta është ideja më e nevojshme e cila e gjeti zbatimin e vet në internet. Interneti u mundëson sot përdoruesve të vet shfrytëzimin e disa serviseve, prej të cilave gjithsesi më të rëndësishmit janë posta elektronike (e-mail) dhe rrjeti botëror (World Wide Web).

Materialisht, rrjeti i kompjuterëve në esencë është rrjet e host- kompjuterëve, të cilët funksionojnë si pika e fundit e bartjes së të dhënave përmes internetit dhe të cilët në shumicën e rasteve prezantohen si "vende" ku gjenden websajtet. ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Katër njohje gjatë muajit maj...

Demir RESHITI

Lituania, San Marino, Çekia dhe Liberia janë katër shtetet të cilat e kanë njohur shtetin e Kosovës gjatë muajit maj, duke e ngritur kështu në 42 numrin e shteteve të cilat janë shprehur të gatshme të vendosin marrëdhënie diplomatike me shtetin më të ri në botë.

Edhe gjatë këtij muaji kanë vazhduar përpjekjet e palës ruse për ta kundërshtuar njohjen e pavarësisë së Kosovës. Madje Rusia së bashku me Kinën dhe Indinë janë angazhuar për vazhdimin e bisedimeve midis Prishtinës e Beogradit, gjë që ka hasur në kundërshtimin e qeverisë amerikane dhe aleatëve të saj evropianë. Zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Sean McCormack ka deklaruar se qeveria amerikane konsideron se çështja e statusit të Kosovës është punë e kryer. Edhe ish- i dërguari i BE-së për negociatat shtesë për statusin e Kosovës, tashti kryesues i ri i Konferencës së Munihut për Politikat e Sigurisë, Wolfgang Ischinger, ka përsëritur qëndrimin se pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë.

Kosova dhe e ardhmja e sigurisë së Ballkanit ka qenë temë e Kuvendit Parlamentar të NATO-s që është mbajtur në Berlin...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit maj 2008.



(1 maj) DASH: Në Kosovë ka elemente shqetësuese për sigurinë

Uashington - Raporti më i fundit për terrorizimin i Departamentit amerikan të shtetit flet për ekzistimin e disa elementeve shqetësuese që kërcënojnë sigurinë në Kosovë. Raporti i publikuar alarmon për ekzistencën e numrit të madh të OJQ-ve, duke konstatuar se disa, nga 400 prej tyre, mund të kenë qenë të involvuara në rrjetin e organizatave që financojnë dhe ndihmojnë terrorizmin.

(3 maj) Rusia nuk konsideron se është përjashtuar nga bisedimet për Kosovën

Moskë -Rusia nuk konsideron se është përjashtuar nga bisedimet për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Shefi i diplomacisë ruse Sergej Lavrov, ka thënë se nuk ishte në dijeni të takimit në Londër të zyrtarëve të lartë të SHBA-së, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë dhe Italisë, ku është diskutuar edhe për mundësitë që të ndihmohet tranzicioni në Kosovë. Sipas tij, në qoftë se do të merrej ndonjë vendim jashtë Rezolutës 1244, atëherë ai do të kërkonte një rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit.


Branko Crvenkovski

(4 maj) Cërvenkovski: Kosova "rrezik për rajonin"

Shkup - Presidenti i Maqedonisë, Branko Cërvenkosvki, sërish e ka quajtur Kosovën rrezik për rajonin. Këtë herë ai i është referuar ndarjes së mundshme të Kosovës në baza etnike. "Rrezik i madh është nëse arrihet deri te ndarja e Kosovës në bazë etnike, ndërkohë që disa elemente të ndarjes së tillë tashmë po duken, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës. Nëse arrihet deri në ndryshimin e kufijve në linjë etnike, kjo gjë mund t'i zgjojë strukturat radikale që ekzistojnë gjithkund në rajon, duke përfshirë edhe Maqedoninë", ka thënë Cërvenkovski.


Lituania

(6 maj) Lituania pranon pavarësinë e Kosovës

Vilnius -Lituania e ka njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Vendimin e ka marrë Parlamenti i Republikës së Lituanisë. Parlamenti lituanez i rekomandon qeverisë së këtij vendi që të fillojë procedurën për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes të Lituanisë e Kosovës. Lituania bëhet shteti i 39-të i OKB-së dhe i 19-të i BE-së që e njeh pavarësinë e Kosovës.

(8 maj) Qeveria gjermane kundërshton zgjedhjet lokale serbe në Kosovë

Berlin - Qeveria gjermane i ka raportuar Komisionit të jashtëm të Bundestagut për bazën juridike të zgjedhjeve serbe në Kosovë. Deputetja socialdemokrate, Uta Zapf, ka thënë se qeveria gjermane ishte e mendimit se serbët kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet parlamentare, sepse ata kanë nënshtetësinë serbe, por jo në zgjedhjet komunale.

(9 maj) Spanja do të dërgojë trupa në misionin paqeruajtës në Kosovë

Madrid-Vendimi i Spanjës për të mos e njohur pavarësinë e Kosovës nuk paraqet pengesë për Madridin që të kontribuojë me trupa në misionin paqeruajtës të NATO-s, ka thënë kreu i NATO-s, Jap de Hoop Schefferin, pas takimit me shefin e diplomacisë spanjolle, Migel Anhel Moratinos.

(12 maj) Kosova merr përkrahje nga Pakistani dhe Meksika

Tiranë - Kosova merr mbështetje nga Meksika dhe Pakistani. Deklaratat janë bërë nga ambasadorë përkatës me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale presidentit shqiptar, Bamir Topi. Ambasadorja pakistaneze, Tasnim Aslam, theksoi se vendi i saj ka mbështetur kauzën e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në Konferencën Islamike.

(13 maj) Republika e San Marinos ka njohur pavarësinë e Kosovës

San Marino- Shteti i vogël evropian San Marino e ka njohur Republikën e Kosovës. Ky minishtet, që është i rrethuar me toka italiane dhe është anëtar i OKB-së, e ka bërë publike njohjen më 11 maj, njofton televizioni SanMarinoTV. Bashkë me këtë njohje, numri i shteteve që e kanë njohur Kosovën deri tash ka arritur në 40.

(16 maj) McCormack: Për SHBA-n statusi i Kosovës është i kryer

Uashington -Qeveria amerikane konsideron se çështja e statusit të Kosovës është punë e kryer - ka deklaruar në Uashington zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Sean McCormack, duke komentuar angazhimin e Rusisë, Kinës dhe Indisë për vazhdimin e bisedimeve midis Prishtinës e Beogradit.


Wolfgang Ischinger

(18 maj) Ischinger: Pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë

Munih - Ish- i dërguari i BE-së për negociatat shtesë për statusin e Kosovës, tashti kryesues i ri i Konferencës së Munihut për Politikat e Sigurisë, Wolfgang Ischinger, ka përsëritur qëndrimin se pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë. "E konsideroj me të vërtetë, si edhe përpara, të paalternativë pavarësinë e Kosovës."

(21 maj) Çekia njohu sovranitetin e Kosovës

Pragë - Qeveria e Çekisë ka njohur shtetin e Kosovës, ka kumtuar kryeministri çek Miroslav Topolanek në një konferencë për media, pas një mbledhjeje në Teplicë - kanë njoftuar mediat çeke. "Çekia do të vendosë marrëdhënie diplomatike me Kosovën", ka paralajmëruar Topolanek. Çekia është vendi i 41-të që ka njohur shtetin e Kosovës.

(23 maj) Di Carlo: SHBA-ja po negocion përfshirjen e saj në EULEX

Prishtinë - Ndihmësnënsekretarja amerikane e shtetit Rosemary Di Carlo ka deklaruar në Prishtinë se SHBA po negociojnë për përfshirjen e tyre në Misionin e Bashkimit Evropian për polici dhe drejtësi në Kosovë, EULEX. Zonja Di Carlo ka thënë se SHBA-ja po angazhohet për të ndihmuar Kosovën gjatë fazës së tranzicionit, kur pritet bartja e përgjegjësive nga UNMIK-u tek qeveria e Kosovës dhe një pjesë te EULEX-it.

(24 maj) Kosova - temë e Kuvendit Parlamentar të NATO-s në Berlin

Berlin- Kosova dhe e ardhmja e sigurisë së Ballkanit, Kosova, Serbia dhe fakti se çfarë do pasojë në të ardhmen, këto janë temat që janë shpalosur në programin e Kuvendit Parlamentar të NATO-s që është mbajtur në Berlin.


Javier Solana

(26 maj) Solana: Po punohet për mënjanimin e pengesave rreth vendosjes së EULEX-it në Kosovë.

Bruksel - Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme e siguri, Javier Solana, në takimin e ministrave të Jashtëm të BE-së në Bruksel, ka thënë se po punohet për heqjen e pengesave në vendosjen e EULEX-it në Kosovë, duke shtuar se për këtë do të bisedojë me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon.

(27 maj) Steinmeir: EULEX deri më 15 qershor do të marrë dritën e gjelbër nga OKB-ja

Berlin – Shefi i diplomacisë gjermane Frank Walter Steinmeir ka shprehur bindjen se EULEX-i, deri më 15 qershor, do të marrë dritën e gjelbër nga OKB-ja për fillimin e punës në Kosovë dhe kjo, sipas tij, do të bëhet përkundër refuzimit të Rusisë. "Nuk bën të lejojmë krijimin e një vakumi të sigurisë dhe paqes në Kosovë" - ka thënë Steinmeir, në ditën e fundit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Berlin, duke aluduar për kalimin sa më të shpejtë të kompetencave të UNMIK-ut tek Misioni civil EULEX, si dhe marrjen e përgjegjësisë dhe ndërtimin e strukturave ligjore në Kosovë.


Scheffer dhe Ki-Moon

(29 maj) Ban e Scheffer biseduan për rolin e UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë

Nju Jork- Kreu i OKB-së, Ban Ki-Moon dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Scheffer, kanë biseduar në Nju Jork për situatën në Kosovë. Në komunikatën e lëshuar nga ky takim, thuhet se Ban Ki Moon ka paraqitur shefit të NATO-s vizionin e tij, duke marrë parasysh edhe brengosjen që ekziston në NATO.

(30 maj) Republika e Liberisë njohu Kosovën shtet të pavarur e sovran

Monrovia- Qeveria e Liberisë i është bashkuar shteteve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në njohjen e Kosovës, duke u bërë shteti i 42-të që njohu Republikën e Kosovës. Pas Senegalit dhe Burkina Fasos, ky është vendi i tretë afrikan që e njeh Republikën e Kosovës. Lajmin e ka bërë të ditur gazeta e përditshme liberiane "Dayli observer". ■

Në sallën e sporteve "1 tetori" është mbajtur manifestim për nder të 100 ditëve



Mesazh paqeje për shtetin e

Në nderim të pishtarit të paqes, Muhammedit a.s. dhe shënimit të 100 ditëve të pavarësisë së Kosovës, Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës (BIRK) në bashkëpunim me Departamentin e të Rinjve të BIRK-ut dhe me shoqatën kulturore "Zëri Ynë" ka organizuar manifestimin "Mesazhi i Paqes". Manifestimi është mbajtur më 26 maj në sallën e sportit "1 Tetori", në Prishtinë, e cila ishte e mbushur plot e përplot me qytetarë që kishin ardhur nga të gjitha qendrat e Kosovës.
Manifestimin e shpalli të hapur Myftiu i Kosovës Mr. Naim ef. Tërnava, i cili duke përshëndetur të pranishmit, paralajmëroi se manifestime të ngjashme, që promovojnë paqen, do të organizohen nëpër të gjitha komunat e Kosovës.
Me kumtesa shkencore për rëndësinë e paqes, lirinë dhe tolerancën që ofron Islami, si dhe personalitetin e Muhammedit a.s., janë paraqitur prof. dr. Pajazit Nushi, prof. dr. Milazim Krasniqi, mr. Besa Ismaili – Ahmeti dhe Kryeimami i Kosovës mr. Sabri ef. Bajgora. Ndërsa në pjesën artistike të manifestimit janë paraqitur Enver Petrovci, Ismet Azemi, Basri Lushtaku, etj.



Myftiu i Kosovës, Mr. Naim ef. Tërnava, duke hapur manifestimin. Tërnava me këtë rast ka falënderuar familjet Jashari, Haradinaj, Pajaziti, Ramadani e shumë familje dhe dëshmorë të tjerë. Myftiu, në emër të popullit të Kosovës, të Bashkësisë Islame dhe në emrin e tij ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuuar për lirinë në shtetin e pavarur të Kosovës.
Tërnava me këtë rast ka kritikuar elitën politike dhe mediat për mosprezencën e tyre në manifestim.



Imami Xhelal Kaloshi, që ka ardhur posaçërisht nga Gjermania për këtë ngjarje, lexon Kur'an.

të Pavarësisë së Kosovës

Kosovës



Prof. Dr. Pajazit Nushi është paraqitur me kumtesën "Profili i mundshëm psikologjik i Pejgamberit Muhammed a.s."


Më një ilahi është paraqitur edhe kori i meshkujve të Medresesë së Mesme "Alauddin"


Kumtesën "Një mesazh i përhershëm për tërë njerëzimin" e ka paraqitur prof. dr. Milazim Krasniqi.



Aktori Ismet Azemi duke recituar poezinë "Rrofsh o Vatan i përkëdhelur" të autorit Kemal Ef. Aruçi.


Kryeimami i Kosovës Mr. Sabri Bajgora duke e lexuar kumtesën me temën "Muhammedi a.s. – Njeriu që ndryshoi historinë e njerëzimit"


Flamur Maloku duke recituar poezinë "Jam musliman".


Myftiu Tërnava si shenjë mirënjohje për kontributin dhe gjakun e derdhur për lirinë e Kosovës, u ka ndarë çmimin për paqe "Mulla Idriz Gjilani" familjeve Jasharaj, Haradinaj, Pajaziti, Ramadani, etj.


Kori i vajzave të Medresesë së Mesme "Alauddin", nën përkujdesjen e dirigjentes Shqipe Bajraktari, anëtare e Filarmonisë së Kosovës, është paraqitur me ilahinë "Në Mekën e largët n'Arabi" të autorit Naim ef. Tërnava.


Artisti i ri Agron Ahmeti duke kënduar ilahi.


Mr. Besa Ismaili – Ahmeti në kumtesën e saj ka folur për të drejtat dhe liritë e grave nga prizmi islam dhe për qëndrimin e Muhammedit a.s. ndaj tyre.


Aktori ynë i famshëm Enver Petrovci ka përmbyllur manifestimin me deklamimin e Fjalimit Lamtumirës të Pejgamberit Muhammed a.s.

Përgatiti:
Osman D. GASHI

Si ta perceptoj identitetin tim në Ko



Emine A. VEZAJ

"Për Kosovën identiteti nuk është vetëm çështje unik

*(**Janusz Bugajski**, Drejtor i "Eas*

Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe njohja e pavarësisë së saj nga një pjesë e konsiderueshme e shteteve të tjera i shton vendit tonë epitetin si shteti më i ri në botë. Tani që ka lindur një shtet i ri, kanë lindur edhe perceptime të reja rreth prezantimit të identitetit të një qytetari të Kosovës.

Tani që jemi shtet, si duhet ta prezantojmë veten ne, që jemi pjesë e kësaj lindjeje të re, tek të tjerët, si qytetarë të Republikës së Kosovës, si kosovarë, si shqiptarë?... Lista do të zgjatej edhe më sikur të merrnim parasysh edhe opinionet e disa njerëzve kur flasin rreth identitetit tonë "ilir".

Cili do të jetë identiteti im dhe si ta perceptoj unë këtë identitet të ri?

Me gjithë faktin se që nga përfundimi i luftës na vetëdijesuan për një identitet të ri "kosovar", prapë se prapë, ne prezantohemi si shqiptar. Në ato kohë të turbullta që kaluam, u vetëdijesuam se kemi identitetin tonë personal, pra sipas fqinjëve tanë ballkanas - shqiptarëve të Shqipërisë, ne jemi shqiptarë-kosovarë, ndërsa deri atëherë ishim mësuar dhe edukuar nga edukatorët tanë se ne jemi një komb shqiptar. Por, sipas paradigmës së kaluar, ne tani nuk jemi të tillë. Për çudi, ne kishim një model tjetër në sytë e fqinjëve tanë, ne tashmë jemi kosovarë. Tani, me ndryshimin e statusit të shtetit tim, si ta perceptoj identitetin tim në Kosovën e Pavarur?

Çka është identiteti?

Identiteti është elementi më kryesor i njeriut përmes të cilit individi prezanton veçoritë dhe karakteristikat me të cilat është pajisur. Identiteti përfaqëson veçoritë më kryesore të individit, apo të një grupi njerëzish, me të cilët është më lehtë ta dallosh nga të tjerët. Identitet do të thotë vetëdije dhe gatishmëri për ta njohur veten se kush je.

Sipas terminologjisë latine identiteti ka të bëjë me: "të qenët i veçantë nga të tjerët dhe i njëjtë me vetveten në disa veçori e tipare që shërbejnë për t'u njohur pa vështirësi si i tillë, të qenët po ai". Rrjedhimisht, identiteti kombëtar është prezantim i një vendi apo thënë ndryshe, paraqet flamurin e identitetit personal të një kombi.



Thënia e Sokratit "Njihe vetveten" sikur është ndër shprehjet më të rëndësishme të problematikës së identitetit që ngërthen pyetësorin "Kush jam unë?" Njeriu identitetin e tij e kultivon me pasurinë dhe arritjet e tij që i realizon në mënyrë të pavarur dhe çdo gjë që mban vulën e tij, në një farë mënyre, është prezantim i identitetit personal.

Në debatet e pafundme Qose - Kadare rreth një identiteti shqiptar, nuk ishte identiteti shqiptar ai që paraprinte në këto debate dhe replika të nxehta mes dy studiuesve të kalibrit më të lartë që kanë dy vendet,Kosova dhe Shqipëria, por ishte identiteti fetar ai që paraprinte këto debate.

Deklarimi i akademik Rexhep Qoses dhe thelbi i shkrimit të tij rreth një identiteti kombëtar dhe një vetëdije fetare, sipas të cilit "shqiptarët s'kanë pse të shtiren si evropianë, ngaqë ata i takojnë qytetërimit islam hiç me pak se qytetërimit krishterë", kishte tingëlluar keq në veshët e Kadaresë. Tani ne që kemi një shtet të ri, a do të duhet të kemi edhe një identitet të ri, për të shuar të gjitha debatet e pafundme të politikanëve e studiuesve të ndryshëm që debatojnë rreth nesh?

Deklarata e Pavarësisë e lexuar nga Kryeministri Hashim Thaçi, në pikën 2 e shpalli Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike... Tani, pas kësaj, nga do të fillojnë polemikat ose debatet e nxehta politikanët e studiuesit tanë? A i ka shuar Deklarata e Pavarësisë debatet e nxehta të tyre, apo ata janë duke u menduar që të kapen pas një identiteti të mirëfilltë kosovar apo shqiptar?

Çka kemi të përbashkët me "fqinjët" tanë shqiptarë?

Në burimet historike, shqiptarët njihen me lloj-lloj emrash dhe nocionesh. Sipas burimeve latine shqiptarët njihen me emrin "Arbaneses" ose "Albaneses", në burimet sllave (që i kemi dëgjuar si shpesh) ne etiketohemi me emrin "Arbanaci", në burimet turke si "Arnavut" e të ngjashme. Qëllimisht përmenda këto nocione të emrit apo nocionit shqiptar për ta ndërlidhur këtë nocion me realitetin e qytetarëve të Kosovës. Ndërsa shqiptarët, turqit, boshnjakët, romët e serbët janë qytetarë të Republikës së Kosovës, si do të duhej të prezantonin veten e tyre tek të tjerët, me nocionin e emrit shqiptar, nga prejardhja e gjuhëve të tyre, apo me një identitet të ri kosovar?

Në Gadishullin Ballkanik, në veçanti në shtetet si Serbia, Kroacia e Bosnje Hercegovina, elementin identifikues e zë diku feja, diku etniciteti. P.sh. serbët dhe kroatët që jetojnë në Bosnje Hercegovinë, për identifikim të tyre zgjedhin termat serb dhe kroat, ndërsa emri boshnjak është një lloj identifikimi i një muslimani boshnjak që paraqet identitetin etnik dhe fe-

osovën e pavarur?

ke, por edhe e subjektivitetit politik dhe ekzistencës kombëtare"

tern European Program" në Qendrën për Studime Strategjike, Uashington)

tar. Te shqiptarët, në përgjithësi, ka ndodhur e kundërta, para prezantimit të fesë, para së gjithash, të gjithë janë prezantuar si shqiptarë. Tani, pavarësimi i Kosovës e sidomos ligji mbi festat zyrtare në Kosovë hapi sërish një debat: nëse Kosova duhet të krijojë një identitet të ri që sipas projektuesve të ligjit mbi festat do të arsyetonte formimin e një kombi të ri?

Kosova pas shpalljes së pavarësisë, de facto dhe de jure, është një shtet me koncept të ri politik, por a përmbledh në vete edhe një identitet kosovar? Dhe a është një mundësi reale që një shqiptar nga Shqipëria të ndihet me shqiptar se një shqiptar nga Kosova? A jemi në shqiptarët një rast sui generis që me shekuj ka kultivuar ndjenjën e atdhedashurisë e bashkimit kombëtar, dhe tani mbetet pa histori e pa kulturë?


Tani do të doja të shtroj një çështje tjetër në këtë studim për të dalë në një përfundim më të arsyeshëm. Cilat janë elementet që përfaqësojnë identitetin e një shteti? Është gjuha, është feja, është kultura, apo??? Pyetjet e tilla nuk do të kishin të ndalur, por do të përmendim vetëm një element të rëndësishëm "gjuhën", që na lidh qoftë në fqinjësi, por dhe në një identitet të përbashkët.


Gjuha

Shqiptarët e Ballkanit duke përfshirë Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, flasin gjuhën shqipe, gjuhë që bën pjesë në grupin e gjuhëve indoevropiane. Që të gjithë kemi dy dialekte të rëndësishme, dialektin toskë që mbretëron në viset jugore të trojeve etnike shqiptare dhe dialektin gegë që mbretëron në përgjithësi në Shqipërinë e Mesme dhe në trojet veriore etnike.

Tani a identifikohen komunitet përbërëse të Kosovës që u përmendën më lartë në një komb të vetëm? Përgjigja është e qartë, shqiptarët identifikohen ndryshe, serbët ndryshe, turqit ndryshe, e kështu me radhë. A kanë të gjitha këto komunitete një lidhje të përbashkët gjuhësore, zakonore apo fetare? Sigurisht se jo. A kanë edhe diçka të përbashkët, përpos asaj që jetojnë në një vend që është formuar si shteti më i ri dhe për disa është gjëja më e shtrenjtë e për disa nuk është asgjë tjetër, pos një vendlindje dhe vend jetese?

Tani, çfarë identiteti kam unë në Kosovën e Pavarur? Jam kosovar, jam shqiptar, apo si ta perceptoj identitetin tim para një të huaji që ende nuk e shikon identifikim tim në ndonjë dokument zyrtar? A ta prezantoj veten ashtu si më quajnë shqiptarët e Shqipërisë - kosovar, a të prezantohem si më prezantojnë serbët - albanac, apo të them me një buzëqeshje filozofike: se ne jemi shteti më ri në botë, por kemi identitet të vjetër, "jemi shqiptarë". U mendova të fus edhe identitetin fetar në këtë mes, por e di se do të ketë edhe shumë çka për të shtuar, prandaj do e përfundoj këtë punim vetëm me identitetin tim kombëtar që sërish nuk e di se çfarë e kam... ■





Halim N. Mejzini fituesi i vendit të tretë në Lessedra të Bullgarisë.



Histori Islame (19)

Fjalimi lamtumirës dhe vdekja e Muhammedit s.a.v.s.

Si duket Muhammedi s.a.v.s. ishte njeriu më i lumtur nga të gjithë, sepse i pari që kishte pranuar mesazhin e tij (Islamin) ishte një djalosh dhjetë vjeçar i quajtur Ali ibn Ebu Talib dhe, pak ditë para se të ndërronte jetë, të gjithë shokët e tij kishin pranuar të udhëhiqen nga një adoleshent. Kjo ishte e shkëlqyeshme. Kjo e bëri të buzëqeshur dhe të qetë



Muhamed JUSUFI -KAJOLLI

Pas kthimit nga Tebuku, askush nuk do të provonte ta sfidonte më Muhammedin s.a.v.s. në Gadishullin Arabik. Kështu pra, agjenda e tij do të ndryshonte në vitet në vijim. Në muajt e mbetur të vitit të nëntë, dhjetë dhe në fillim të vitit të njëmbëdhjetë, Muhammedi s.a.v.s. ishte i angazhuar tej mase duke pritur delegacione të shumtë që vinin nga vende të ndryshme të gadishullit. Karakteri i vizitave të tyre ishte njohja e shtetit të ri dhe kërkesa për të mësuar fenë hyjnore.

Megjithëkëtë, disa individë përpiqeshin ta destabilizonin vendin me anë të propagandës dhe atentateve që dëgjoheshin herë pas herë. Por e rëndësishme ishte se atentatorët nuk e kishin më mbështetjen e Bizantit. Ata sikur e kishin humbur ekuilibrin, sepse po drejtoheshin nga një perandor i cili kishte filluar të tregonte shenjat e para të skizofrenisë.

Fjalimi lamtumirës

Shqetësimi i Muhammedit s.a.v.s. ishte shumë i vogël prandaj ai nuk e prishi agjendën e tij dhe në muajin e haxhit të vitit të dhjetë hixhri ai organizoi shkuarjen për në umre dhe haxh. Në haxh morën pjesë më shumë se njëqind e dyzet mijë haxhinj. Meqenëse Muhammedi s.a.v.s. kishte parandjenjën se po i vinte fundi, iu tha haxhinjve të ishin të vëmendshëm dhe të mbanin mend çdo veprim që do të bënte ai.

Në haxhin e lamtumirës, Muhammedi s.a.v.s mbajti në Arafat edhe fjalimin e tij lamtumirës përpara masës së gjerë:

"O Njerëz! Dëgjoni çka do t'ju them, sepse nuk e di nëse do t'ju takoj në këtë vend pas këtij viti.

O njerëz! Kini frikë Zotin dhe respektojeni Atë. Bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve. Kjo është dita e flijimeve në emër të All-llahut. Më të vërtetë gjaku dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend.

Ruajeni, respektojeni dhe nderojeni vlerën e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor. Njeriu është vepër madhështore e All-llahut dhe mjerë ai që e nënçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së All-llahut. Ju, o njerëz, pashmangshëm dhe pakthyeshëm do t'i ktheheni All-llahut të Amshueshëm dhe Ai do t'ju marrë në përgjegjësi për veprat dhe punën tuaj.

O besimdrejtë! Ta dini, ta mbani mend dhe të jeni të bindur se përfundoi koha e mosdijes dhe traditave të këqija që i sollën fatkeqësi të shumta gjinisë njerëzore. Unë jua kam treguar rrugën e shpëtimit nëpër të cilën duhet të shkoni. Gjakmarrja është e ndaluar. Të gjitha akuzat e tilla që rrjedhin nga koha para Islamit, anulohen. Akuza e parë e tillë që anulohet është gjakmarrja e xhaxhait tim, Amir b. Rebi`b. Harith b. Abdulmuttalibit, të cilin pa kurrfarë faji e mbytën njerëzit nga fisi Hudhejl. Kjo gjakmarrje le të harrohet dhe të gjitha të tjerat në të ardhmen le të falen.

Fajdeja dhe kamata janë të ndaluara. Huadhënësi nga huamarrësi duhet ta marrë vetëm atë që vërtet ia ka huazuar. Huatë e para që i nënshtrohen këtij vendimi janë huatë e xhaxhait tim Abbasit, i cili ka pasur mjaft borxhlinj. O besimdrejtë! Duhet t`ua falni kamatat borxhlinjve. Dëgjoni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse juve ju mbetet kryegjëja për tregti dhe punë të ndershme. Nëse nuk e bëni këtë, duhet ta dini se do ta zemëroni thellë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse borxhliu juaj është në vështirësi, duhet t`ia vazhdoni afatin e pagimit, ndërsa nëse jeni në gjendje që t`ia falni borxhin, kjo do të ishte edhe më mirë për ju.

O besimdrejtë! O njerëz! Frikësojuni asaj dite që me siguri do të vijë, kur të gjithë do të paraqiteni para All-llahut, Gjykatësit të Vetëm Suprem, kur ju pret drejtësia absolute. Kur të zotoheni se një borxh do ta paguani me kohë dhe kur ta lidhni marrëveshjen, të gjitha këto bëjini me shkrim dhe theksoni me besnikëri afatin e pagimit. O të vdekshëm! Duajeni dhe dëgjojeni Zotin, Krijuesin e tërë materiales dhe jomateriales, i Cili krijoi meshkuj dhe femra, prej të cilëve u zhvillua gjinia njerëzore. Kini frikë nga All-llahu, me ndihmën, prehjen dhe mëshirën e të Cilit jemi të udhëzuar të gjithë. Ne jemi të vdekshëm dhe në çdo çast jem gjithnjë e më afër vdekjes dhe takimit me Të, me All-llahun e Amshueshëm, me Gjykuesin e Drejtë.

Shprehni respektin e duhur ndaj farefisit. Përmbushni me përgjegjësi të thellë detyrat dhe obligimet që ekzistojnë ndërmjet burrit dhe gruas, ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Fëmija e fiton xhenetin nën këmbët e nënës së tij. Ruajuni nga prostitucioni, tradhtia bashkëshortore dhe xhelozia. Prostitucioni dhe tradhtia bashkëshortore janë mëkate të rënda, ndërkaq xhelozia mund të shkaktojë prishjen e bashkëshortësisë. Martohuni me ato që i doni. E kur vullneti i Zotit t'ju bashkojë, atëherë respektojeni dhe dojeni njëri-tjetrin dhe jetoni në dashuri dhe harmoni të vërtetë.

O bashkëshortë! Silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri. O

besimdrejtë! Largohuni nga ngatërresat dhe përgojimet! Ata që shpifin për gratë e ndershme, le të jenë të mallkuar në të dy botët. Ata që i akuzojnë gratë e ndershme për tradhti në martese ose për amoralitet, ndërkaq që nuk mund të sjellin për këtë katër dëshmitarë të besueshëm, dënojini me tetëdhjetë goditje, dhe asnjëherë mos u besoni në të ardhmen asgjë, sepse ata janë njerëz të këqij.

Nëse mendoni se ndaj grave tuaja nuk e ndjeni më dashurinë e dikurshme, mos nxitoni, por mendoni mirë. Ndoshta All-llahu nëpërmjet këtij sprovimi ju udhëzon në rrugën e fatit të ri të madh, me të cilën dëshiron t'ju përgëzojë. Mos kërkoni shkurorëzim pa shkaqe të arsyeshme, meqë prej të gjitha gjërave që All-llahu i ka lejuar, më së tepërmi e urren shkurorëzimin. Gratë tuaja u janë dorëzuar në besë të Zotit. Respektojeni, o besimdrejtë, atë amanet të Zotit.

O njerëz! Sot djalli i mallkuar është i dëshpëruar, sepse ka pësuar humbje dhe nuk mund të ndikojë më te ju. Por ju, megjithatë, jini gjithnjë të kujdesshëm, që ai i mallkuar të mos ju vë në lajthitje as për gjërat më të vogla. O besimdrejtë! Kur e caktoni dhe e ndani ndërmjet veti trashëgiminë, bëhuni të drejtë dhe përmbajuni librit të Zotit. Ruajeni pasurinë e bonjakëve, të paaftëve dhe të sëmurëve mendore. Zoti ia ka dhënë çdonjërit të drejtën e vet, andaj nuk ka nevojë që trashëgimtarëve t'u lihet testament; ndërsa si testament nuk mund të lihet më tepër se një e treta(1/3) e pasurisë. Fëmija i takon atij në shtratin e të cilit është lindur. Kush pohon se i takon tjetërkujt përveç prindit, atë do ta arrijë mallkimi i Zotit. Nuk i lejohet gruas që të japë diç nga pasuria e burrit të saj pa lejen e tij. Borxhi duhet paguar ndërsa sendi i huazuar duhet kthyer. Dhurata duhet të kthehet me dhuratë. Kush hynë dorëzanë për dikë, obligohet edhe me përgjegjësi për dorëzani. Me robërit dhe shërbëtorët silluni në mënyrë njerëzore. Ushqejini ata siç ushqeheni vetë dhe vishini ata siç visheni vetë. Nuk guxoni t'u bëni keq, as t'i keqpërdorni. Edhe ata janë njerëz, edhe ata janë shërbëtore të Zotit.

O besimdrejtë! Ta dini dhe të mos harroni se të gjithë muslimanët janë vëllezër. Ju të gjithë jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe detyra. Nuk ka kurrfarë përparësie arabi ndaj jo-arabit, e as jo-arabi ndaj arabit, as i ziu ndaj të kuqit, e as i kuqi ndaj të ziut, përveç me devotshmëri. Të gjithë jeni pasardhësit e Ademit, ndërsa Ademi është prej dheut.

O muslimanë! Duhet të kujdeseni, të duheni dhe të ndihmoheni ndërmjet vete. Nuk guxoni ta ofendoni njëri-tjetrin, e as t'i merrni me dhunë njëri-tjetrit diçka. Këto janë mëkate të rënda. Merreni vetëm atë që ju jepet me vetëdëshirë. Respektoni pacenueshmërinë e pasurive tuaja derisa janë në frymën e ligjeve të Zotit. Në punën tuaj Islami dhe interesi i përgjithshëm le të jenë mbi ju dhe interesin tuaj personal. Përkushtojani Islamit jetën tuaj dhe në punën për Islamin jepni prej vetes gjithçka që mundeni. Mos e shkelni kurrë të drejtën dhe nderin e askujt. Mos i bëni vetvetes dhunë. Mos harroni se mëshira është një ndër bazat kryesore të Islamit.

O njerëz! Dëgjoni çka po ju them dhe mbajeni mend mirë. Unë po jua lë librin e Zotit - Kur'anin - të cilit nëse i përmbaheni, do t'ju ruajë gjithnjë që të mos e humbni rrugën e drejtë, rrugën e drejtësisë dhe së vërtetës. Kur'ani është libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e All-llahut, fjalë e Tij, në vërtetësinë e së cilës nuk ka kurrfarë dyshimi.

Para vetes keni tërë jetën time, fjalët dhe veprat e mia. Gjithçka që kam folur dhe punuar, jam përpjekur që të jetë në pajtim të plotë me urdhrat e All-llahut. Ju vërtet nuk do të gjendeni në lajthitje përderisa t'i përmbaheni Kur'anit dhe sunnetit tim.

O besimdrejtë! Thojeni gjithnjë të vërtetën e pastër. Urrejtja asnjëherë le të mos ju largojë nga rruga e të drejtave dhe drejtësisë. Drejtësia është motra e devotshmërisë. Frikësohuni nga All-llahu! Ai e sheh punën tuaj.

O njerëz! I dëgjuat porositë e mia, futini në zemrat tuaja e në jetën tuaj. Të gjithë ata që i kanë dëgjuar këto fjalë të mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar, sepse prej tyre mund të ketë më mbamendës se vetë dëgjuesit.

(Pas një pauze të shkurtër, i Dërguari i Zotit me një zë më të butë ka thënë): "A e përcolla mesazhin e All-llahut tek ju, o njerëz?"

"O i Dërguari i Zotit! Ti e ke përmbushur besnikërisht misionin tënd dhe na ke komunikuar çka të ka urdhëruar Zoti" - u përgjigjën më se 100 000 haxhinjtë e pranishëm.

(Atëherë Muhammedi a.s. me zë solemn tha) : "O Zoti im, dëshmo (për këtë)!

(Të njëjtën ditë, Zoti i Lavdishëm shpalli edhe ajetin e fundit të Kur'anit): **"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë time dhe zgjodha për ju Islamin fe".** (Sure Maide, 3).


Amanetet e fundit

Pas kthimit nga haxhi, Muhammedi s.a.v.s. kishte filluar të linte amanetet e fundit. Pak ditë para se të ndërronte jetë, ai urdhëroi Usame ibn Zejdin të përgatiste ushtrinë e tij për të siguruar kufijtë veriorë. Këtë ekspeditë e kërkoi për arsye të ndjenjës së sigurisë për të gjithë qytetarët e gadishullit dhe, njëkohësisht, që të gëzonin paqen në brendi.

Disa nga shokët e tij më të afërm u habitën me këtë urdhër dhe shprehën pakënaqësitë e tyre. Si do ta udhëhiqte ushtrinë një adoleshent, mendonin në vete!? Ai s.a.v.s., ju tregoi për shkathtësitë që posedonte Usame dhe u kujtoi edhe babanë e tij që kishte rënë dëshmor në Mue'tete me bizantinët. Pas këtij shpjegimi, ata iu bashkuan komandant Usames pa përtesë.

Si duket Muhammedi s.a.v.s. ishte njeriu më i lumtur nga të gjithë, sepse i pari që kishte pranuar mesazhin e tij (Islamin) para 22.5 vjetëve, kishte qenë një djalosh dhjetë vjeçar, që quhej Ali ibn Ebu Talib dhe, pak ditë para se të ndërronte jetë, të gjithë shokët e tij kishin pranuar të udhëhiqen nga një adoleshent. Kjo ishte e shkëlqyeshme. Kjo e bëri të buzëqeshur dhe të qetë.

Muhammedi s.a.v.s. ndërroi jetë më 12.03.11 Hixhri, ndërkohë që ushtria e Usames ishte larg Medinës vetëm pesë kilometra. ■



Shifra alarmante të abortit në Kosovë



Florentina LATA

Një familje në Prishtinë kishte vendosur që ta fejonte vajzën e vet V. B. me një djalë shqiptar që gjendej në Zvicër. Familja nuk e dinte se ajo ishte e lidhur me një mashkull tjetër shumë më të vjetër se ajo, me të cilin madje kishte mbetur shtatzënë. Ajo, duke e ditur faktin se nuk ishte ashtu siç mendonin anëtarët e familjes së saj, nuk donte assesi të lidhej me djaloshin mërgimtar. Edhe pse nuk dëshironte, më në fund, insistimet e familjes e kishin bindur V. B.-në që t'i thotë "PO" kësaj oferte martesore...

Dhe në muajin e tretë të shtatzënisë "burri" i saj i ardhshëm kishte ardhur në Kosovë për të bërë ceremoninë e fejesës. Ditën që çifti ndërroi unazat e fejesës, V. B e abortoi fëmijën e "partnerit" të saj. Të njëjtën ditë, ajo bëri edhe intervenime të tjera kirurgjike në himen, duke "rikthyer" virgjërinë e saj.

E lodhur nga abortimi dhe "rivirgjërimi", në ditën festive të fejesës, ajo nuk ndihej assesi mirë. Të gjithë këndonin, vallëzonin. I fejuari i V.B.-së, shkëlqente nga gëzimi se kishte gjetur vajzën e ëndrrave. Familjarët e saj buzëqeshnin për vajzën e tyre...

Çifti u martua dhe shkoi të jetonte në Zvicër. Burri i saj nuk dinte asgjë për lidhjen e saj të mëparshme dhe për abortimin që kishte pasur bashkëshortja e tij. Kaloi një kohë e gjatë e nusja nuk po mund të mbetej shtatzënë, përkundër dëshirës së dy bashkëshortëve. Një ditë, V. B. vendos të shkojë të konsultohet me mjekët zviceranë për shkaqet e mosngeljes me barrë. Mjekët i thanë se si pasojë e abortimit, ajo nuk do të mund të lind më asnjëherë fëmijë.

Megjithëkëtë, edhe pse nuk janë trashëguar, ata vazhdojnë lidhjen e tyre martesore. Bashkëshorti i saj, deri më tash, nuk e ka kuptuar të vërtetën. Ai, madje si shenjë e dashurisë së tij, ka vendosur t'i qëndrojë besnik, duke hequr dorë nga dëshira që të ketë pasardhës...

Për fat të keq, sot, kemi shumë raste të tilla në shoqërinë tonë. Janë me mijëra gra që e kanë zgjedhur abortin si rrugën për të ndërprerë shtatzëninë e padëshiruar.

Paçarada: Pacientet këshillohen për planifikim të familjes në mënyrë që të mos aplikohet aborti

Gjinekologia Myrvete Paçarada thotë se aborti paraqet ndërprerjen e shtatzënisë, në mënyrë spontane ose me qëllim, para se fryti të zhvillohet mjaft, për të mbijetuar jetën jashtë mitrës. Zakonisht, aborti definohet si përfundimi i shtatzënisë para javës së 20-të, ose në peshën më të ulët se 500 gr.



Sipas saj, kemi tri lloje abortesh. Gruas i lejohet ta zgjedhë abortin dhe ky vendim merret mes saj dhe gjinekologut.

"Çdo grua ka të drejtë të vendosë për mënyrën e abortit në rast se dëshiron të ketë abort artificial (me dëshirë), gjatë të cilit bëhet ndërprerja e barrës me dëshirën e gruas dhe jo për shkak të indikacioneve të shëndetit të nënës ose sëmundjeve të frytit.

Aborti artificial medikamentoz, ose aborti i hershëm, është një formë tjetër alternative në shtatzënitë deri në 49 ditë. Aborti artificial medikamentoz realizohet me aplikimin e barërave (antiprogestin-mifepristone, antimetabolit-methotrexate dhe prostaglandina-misoprostol). Këta agjentë shkaktojnë abort me rritjen e kontraktilitetit të mitrës, qoftë me reversionin e inhibimit të kontraksioneve nën ndikimin e proesteronit, qoftë me stimulimin e miometriumit direkt.

Gjithashtu, kemi edhe abortin kirurgjik gjatë të cilit paraqitet evakuimi i përmbajtjes së koncepcionit nëpërmes qafës së mitrës. Ky lloj aborti realizohet me dilatimin e qafës së mitrës dhe kiretazhet me mjete të mprehta".

Sipas Paçaradës, pothuajse të gjitha pacientet këshillohen për planifikimin e familjes, në mënyrë që të mos aplikohet aborti si metodë kontraceptive.

Ligji e lejon abortin deri në javën e dhjetë të shtatzënisë

Aborti në Kosovë është i lejuar me ligj deri në javën e dhjetë të shtatzënisë vetëm më kërkesën e gruas. Miratimi i prindit kërkohet nëse femra është nën moshën 16 vjeçare.

Sipas të dhënave që arritëm të sigurojmë në QKUK, numri i aborteve ka shënuar rënie. Ndonëse shifrat dallojnë shumë, edhe në të dhënat e siguruara

nga Enti i Statistikave të Kosovës, trendi i abortimeve ka shënuar rënie.

Në QKUK, gjatë vitit 2005, janë bërë gjithsej 486 aborte, prej të cilave 16 kanë qenë gra nën moshën 20 vjeçare; 236 të moshës 20-35 vjeçare; dhe 234 mbi moshën 35 vjeçare.

Gjatë vitit 2006 janë bërë gjithsej 300 aborte, prej të cilave 7 nën moshën 20 vjeçare, 163 të moshës 20-35 vjeçare dhe 130 të moshës mbi 35 vjeçare.

Ndërkaq, gjatë vitit 2007 janë bërë gjithsej 293 aborte, prej të cilave 8 kanë qenë gra nën moshën 20 vjeçare, 152 të moshës 20-35 vjeçare dhe 133 të moshës mbi 35 vjeçare.

Sipas Entit të Statistikave të Kosovës, në vitin 2005 janë bërë gjithsej 2002 aborte, prej të cilave numri më i madh sipas grup moshave është 20-29 vjeç, me 855 raste. Ndërkaq, në vitin 2006 janë bërë gjithsej 1651 aborte, ku gjithashtu kanë dominuar gratë e grupmoshës 20-29 vjeçare, me 676 raste.

Bashota: Feja islame nuk e lejon abortin

Ardita Bashota, njohëse dhe ligjëruese e fesë islame, thotë se nuk është e drejtë e gruas të abortojë. Edhe pse ai embrion është vendosur në mitrën e saj, ai është pronë i All-llahut. Prandaj, në Islam ka ligje dhe rregulla për këtë.

"Aborti në Islam është i ndalur në të gjitha fazat e embrionit, sepse All-llahu në Kur'an ka thënë: 'mos mbytni pa të drejtë asnjë njeri'. All-llahu i lartësuar është kujdesur për të drejtat e njeriut qysh kur ai është embrion në mitrën e nënës dhe, në disa ajete, Ai na tregon se si e vendosi atë, pra embrionin, në një banesë të sigurt, pra në mitrën e nënës, ku ai të mund të zhvillohet".

Sipas Bashotës, aborti nuk lejohet të bëhet për hir të dëshirave të dikujt, sepse është përgjegjësi e gjithë shoqërisë që të kujdeset për një krijesë që All-llahu ka vendosur ta sjellë në këtë botë.

"Aborti, nganjëherë, bëhet për shkak të gjinisë. Zakonisht abortohen fëmijët e gjinisë femërore. Është për t'u habitur se si në kohën e civilizimit të madh njerëzor ka ende mendime të tilla dhe gjykohet në bazë të gjinisë. Në Kur'an kjo është një gjë e urryer sepse All-llahu vendos se kujt t'i japë vajza, e kujt djem" – thekson Bashota. ■

Mbulesa e femrës midis të kaluarës dhe të tashmes

Nexhat IBRAHIMI

Një ndër pikat më problematike ndërmjet muslimanëve dhe traditës perëndimore, gjatë shekullit XX-XXI, është mbulesa e femrës, përkatësisht vendosja e shamisë për femrat muslimane. Në sytë e perëndimorëve, shamia (hixhabi, mbulesa në përgjithësi) konsiderohet shkelje e të drejtave njerëzore, robërim i femrës, prapambetje dhe mosemancipim.

Problemi është tejet kompleks dhe kërkon studime teorike e praktike prandaj edhe akcesi ynë me këtë rast do të jetë i shkurtër, sa për të theksuar se kjo temë mund të trajtohet edhe ndryshe, në mënyrë më afirmative si për myslimanët, ashtu edhe për evroperëndimin (traditën judeo-kristiane).

Në këtë rrugëtimin tonë, së pari do të shtrojmë një pyetje praktike.

Meqenëse edhe judaizmi, por edhe kristianizmi aktual, e kritikojnë mbulesën e femrës muslimane, do të bëjmë një pyetje dhe do të hulumtojmë se si është trajtuar mbulesa te këto dy fe qiellore dhe a kemi tradita të tilla apo të ngjashme edhe në judaizëm e kristianizëm, rspektivisht, mos është shamia tipike vetëm për muslimanët? Si të komentohen shkrimet në librat historikë, por edhe pamjet filmike që flasin apo pasqyrojnë të kaluarën e tyre, ku shamia është pjesë përbërëse e qenies së tyre fetare dhe nacionale!

Faktet flasin kundër deklarimit të tyre aktual. Shkurtimisht do të hedhim një shikim në disa shkrime nga traditat e tyre fetare apo nga goja e autorëve të tyre, të cilat për fat të mirë krahas anglishtes i gjetëm të përkthyera edhe në kroatisht, por edhe shqip.

Tradita çifute

Mbulesa e femrës nuk është sihariq musliman, as sajim i muslimanëve, as ndonjë masë ndëshkimi për gjininë e kundërt. Edhe judaizmi këmbëngul që femrat të mbulohen. Në "Librin e Parë të Mojsiut" shtohet se Rebeka ishte mbuluar kur takoi burrin e saj të ardhshëm Izakun (Is'hakun a.s.), sepse ai ishte i huaj për të në atë kohë. Po kështu, thuhet edhe për Tamaren, nusen e Judës, kur doli nga shtëpia e babait në publik.

Mbulesa ishte edhe shenjë e statusit shoqëror të femrës, të pasurisë dhe të jetës luksoze të saj. Herë-herë mbulesa ishte demonstrim i fisnikërisë, bujarisë dhe nderit. Femra kokëzbuluar ka mundur të akuzohej për mosbesim dhe prostitucion. Për këtë arsye, në bashkësinë hebraike, prostitutave nuk iu është lejuar të mbulojnë kokat. Kur mbuloheshin, ato kishin për qëllim ta ngrinin respektin e të tjerëve kundrejt tyre. Kjo gjendje ka vazhduar pothuaj deri në shekullin e XIX-të, kur nën ndikimin shekullarist, edhe femra çifute pësoi ndryshime rrënjësore dhe sot mbulesën e kokës e vë vetëm kur hyn në sinagogë.

Mbulesa te çifutët është shumë rigoroze. Femrat te ata mbulohen edhe kur janë vetëm, apo me anëtarët e ngushtë të familjes. Madje, rabini Gemoro thotë se femra nuk bën t'ia zbulojë flokët as mureve të shtëpisë së saj.

Në librin "Femra çifute në literaturën rabiniane – një perspektivë psiko-historike" (The Jewish Woman in Rabbinic Literature - A Psycho-historical Perspective"), rabini dr. Menachem M. Brayer (profesor i komentimit të Biblës në Universitetin Yeshiva), rrëfen se është traditë që femra çifute të dalë në mesin e njerëzve me kokë të mbuluar, e madje duke e mbuluar edhe fytyrën, duke e lënë vetëm një sy të lirë. Ai thekson disa rabinë të lashtë të cilët thonë:

"Nuk i ka hije femrave çifute të shëtitin kokëçelur", si edhe "Qoftë i mallkuar njeriu i cili lejon që flokët e gruas së tij të shihen. Femra që zbulon flokët e saj që të duket më bukur, sjell varfëri."

Ligji rabin ndalon recitimin, bekimin apo lutjen në prani të gruas së martuar kokëçelur, sepse zbulimi i flokëve të zbuluara të femrës konsiderohet një lloj lakuriqësie.

→

Dr Brayer, gjithashtu thotë:

"Gjatë periudhës tanaitike, të mosmbuluarit e kokës nga ana e gruas konsiderohej fyerje e modestisë së saj. Kur koka e saj ishte e zbuluar ajo gjobitej deri në katërqind zuzime për këtë kundërvajtje." Doktor Brayer, gjithashtu, shpjegon se mbulesa e gruas çifute nuk konsiderohej gjithmonë shenjë modestie. Nganjëherë, shamia simbolizonte një gjendje dallimi dhe luksi në vend të modestisë. Mbulesa personifikonte dinjitetin dhe epërsinë e gruas fisnike. Ajo gjithashtu përfaqësonte mosmundësinë e të afruarit një gruaje si pronë e shenjtëruar e të shoqit, që dallon nga konceptimi modern i bartjes së shamisë, ku shamia sipas tyre paraqet degradim të femrës.


Burimet fetare çifute, si Dhiata e Vjetër, zbulimin e kokës së gruas e konsiderojnë si paturpësi të madhe dhe kjo është arsyeja që kleriku duhej ta zbulonte adulteristen e dyshuar në gjyqin e saj të provës së rëndë. (Numrat 5:16-18)

Shamia nënkuptonte vetërespektin dhe statusin shoqëror të gruas. Gratë e klasave të ulëta shpesh vishnin shaminë për të dhënë përshtypjen e një rangu më të lartë. Fakti se shamia ishte shenja e fisnikërisë, përbënte arsyen pse prostitutave nuk u lejohej të mbulonin flokët në shoqëritë e vjetra çifute. Megjithatë, prostitutat shpesh vinin një mbulesë koke për t'u dukur të respektueshme. Gratë çifute në Evropë vazhduan t'i vishnin shamitë deri në shekullin e XIX, kur jetët e tyre u bënë më të përziera me kulturën shekullare rrethuese. Por, trysnitë e jashtme të jetës evropiane në shekullin e XIX-të, sidomos trysnia e mësimeve shekullariste, i detyruan shumë gra çifute të dalin jashtë kokëzbuluar. Disa gra çifute e panë më të volitshme të zëvendësojnë shaminë e tyre tradicionale me një paruke si një formë tjetër e të mbuluarit të flokëve. Sot, shumica e grave fetare çifute nuk i mbulojnë flokët e tyre, përveçse në sinagogë. Disa nga ato, si p.sh. sektet hasidike, ende përdorin paruken.

Tradita kristiane

Tradita kristiane, gjithashtu, i kushton vëmendje problemit të mbulesës. Gjurmë për këtë gjejmë edhe te vetë murgeshat katolike, të cilat i mbulojnë kokat e tyre që prej kohësh, por kjo s'është e gjitha. Shën Pali në Dhiatën e Re ka bërë disa pohime shumë interesante për shaminë:

"Tani unë dua që ju të kuptoni se koka e çdo burri është Krishti, dhe koka e çdo gruaje është burri, dhe koka e Krishtit është Zoti. Çdo njeri që lutet apo predikon me kokë të mbuluar çnderon kokën e tij. Dhe çdo grua që lutet apo predikon me kokë të zbuluar çnderon kokën e saj - është tamam sikur koka e saj të jetë e rruar. Nëse një grua s'e mbulon kokën e saj, asaj duhet t'i priten flokët; dhe nëse është turp për një grua t'i ketë flokët e qethura ose të rruara, ajo duhet ta mbulojë kokën. Një burrë s'duhet ta mbulojë kokën e tij, ngaqë ai është shëmbëllimi dhe lavdia e Zotit, por gruaja është lavdia e burrit. Sepse nuk erdhi burri nga gruaja, por gruaja nga burri dhe as burri s'u krijua për gruan, po gruaja për burrin. Për këtë arsye dhe për shkak të engjëjve, gruaja duhet të ketë një shenjë autoriteti mbi kokë." (I Korinthiasit 11:3-10)



Arsyetimi i Shën Palit për gratë e mbuluara është se mbulesa përfaqëson një shenjë autoriteti të burrit - që është shëmbëllimi dhe lavdia e Zotit – mbi gruan, që u krijua prej dhe për burrin.

Shën Tertuliani në traktatin e tij të njohur 'Mbi Mbulimin e Virgjëreshave', shkruante:

"Gra të reja, t'i vishni shamitë jashtë në rrugë, po kështu t'i vishni në kishë, t'i vishni kur jeni mes të huajve, pastaj t'i vishni midis vëllezërve tuaj."

Midis ligjeve kanunore të Kishës Katolike sot ekziston një ligj që kërkon patjetër nga gratë që t'i mbulojnë medoemos kokat kur hyjnë në Kishë. Disa degëzime kristiane, siç janë ato të amishëve dhe memonitëve, për shembull, vazhdojnë t'i mbajnë gratë të mbuluara deri sot e kësaj dite. Arsyeja për mbulesën që ofrohet nga udhëheqësit e tyre të Kishës është se "mbulesa e kokës përbën simbol të nënshtrimit të gruas ndaj burrit dhe Zotit." E njëjta logjikë paraqitej nga Shën Pali në Dhiatën e Re.

Tradita islame

Hulumtimi i librave fetarë dhe tradicionalë fetarë çifuto-kristianë tregon qartë se nuk e shpiku Islami mbulesën e kokës, shaminë, hixhabin për femrën. Përkundrazi, Islami e gjeti këtë traditë dhe e konfirmoi atë. Kur'ani i urdhëron burrat dhe gratë besimtare të ulin shikimin ngulmues dhe të ruajnë modestinë e tyre, e pastaj i urdhëron gratë besimtare t'i zgjasin mbulesat e tyre deri tek duart dhe kraharori:

"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet dhe të ruajnë modestinë e tyre ... thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë bukurinë dhe stolitë e tyre, përveç atyre (stolive) që janë (gjithsesi) të dukshme; le të vënë shamitë mbi kraharorët e tyre." (24:30-31)

Kur'ani është tepër i qartë në të treguarit se mbulesa është pjesë kyçe e një recete të krijuar për qëllimet e modestisë. Po përse vallë modestisë? Kur'ani është përsëri i qartë:

"O Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, le të vënë shamitë e veta mbi trupat e tyre, që të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen (a cenohen)." (33:59).

Kjo është e gjithë çështja, modestia është parashtruar që të mbrojë gratë nga ofendimet, apo thjesht - modestia është mbrojtje. Kështu, qëllimi i vetëm i mbulesës në Islam është mbrojtja. Mbulesa islame, në ndryshim nga ajo e traditës kristiane, nuk është shenjë e autoritetit të burrit mbi gruan dhe as shenjë e nënshtrimit të saj ndaj tij. Mbulesa islame, në ndryshim nga tradita çifute, nuk është shenjë luksi dhe dallimi për disa gra të martuara të fisme. Mbulesa islame është vetëm shenjë modestie për arsyen e vetme të të mbrojturit të grave - të gjitha grave. Filozofia islame e mbulesës së femrës qëndron në atë se është gjithmonë më mirë të jesh e sigurt sesa e vajtueshme. Ç'është e vërteta, Kur'ani kështu interesohet për të mbrojtur trupat e grave dhe reputacionin e tyre, saqë një burrë që guxon të akuzojë pa të drejtë një grua për pandershmëri, do të dënohet rreptësisht:

"Dhe ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, rrihini me nga tetëdhjetë goditje dhe atyre mos ua pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm." (24:4)

Krahasojeni këtë qëndrim të rreptë të Kur'anit me dënimin jashtëzakonisht të lehtë për përdhunim në Bibël: "Nëse një burrë ndodh të takojë një virgjëreshë që s'është dakord të martohet (me të) dhe e përdhunon atë e ata zbulohen, ai duhet t'i paguajë babait të vajzës pesëdhjetë shekele argjendi. Ai duhet të martohet me vajzën, sepse ai e ka dhunuar atë. Ai s'mund ta divorcojë atë për sa (kohë ai) të jetë gjallë." (Deuteronomi 22:28-30)

Këtu duhet bërë një pyetje e thjeshtë: kush u dënua në të vërtetë? Burri që vetëm pagoi një gjobë për përdhunimin, apo vajza që detyrohet me forcë të martohet me njeriun që e përdhunoi atë dhe të jetojë me pahir me të gjersa ai të vdesë? Një tjetër pyetje që duhet bërë është: ç'është më mbrojtëse për gratë, qëndrimi i rreptë kur'anor, apo qëndrimi i vakët biblik?

Disa njerëz, sidomos në Perëndim, do përpiqeshin ta përqeshnin argumentin e modestisë për qëllim mbrojtjeje. Argumenti i tyre është se mbrojtja më e mirë është përhapja e edukimit, sjelljes së qytetëruar dhe vetëpërmbajtjes. Ne do thoshim: në rregull, por jo e mjaftueshme. Nëse 'qytetërimi' mjafton për mbrojtjen e grave, atëherë përse gratë në Amerikën e Veriut s'guxojnë të ecin vetëm në një rrugë të errët, madje as përgjatë një vendparkingu të zbrazët? Nëse arsimimi është zgjidhja, atëherë përse një universitet si i Queen's ka një 'walk home service' për studentet në qytezën studentore? Nëse 'vetëpërmbajtja' është përgjigja, atëherë përse vetëm në ShBA ndodh një përdhunim në çdo 12 minuta; përse janë rastet e bezdisjes seksuale në vendin e punës në lajmet e mediave çdo ditë? Një përmbledhje e të akuzuarve për sulme seksuale, në këto pak vitet e fundit, përfshin oficerë marine, menaxherë, profesorë universitetesh, senatorë, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe Presidentin e Shteteve të Bashkuara! Unë s'mund t'i besoja syve kur lexova statistikat e mëposhtme, të shkruara në një pamflet të nxjerrë nga Dekani i Zyrës së Grave në Queen's University:

Në Kanada:

-Një grua sulmohet seksualisht çdo 6 minuta;

-1 ndër 3 gra në Kanada do sulmohet seksualisht në një kohë të jetës së saj;

-1 ndër 4 gra janë në rrezik të përdhunimit ose përpjekjes së përdhunimit jetës së tyre;

-1 ndër 8 gra do to sulmohet seksualisht gjatë ndjekjes së kolegjit universitetit dhe;

-Një studim zbuloi se 60 % e meshkujve në moshë universitare thanë se kryenin lirshëm sulmim seksual po të ishin të sigurt se nuk do të kapeshin!

Në ShBA:

-Femra është rrahur, në shtëpi apo jashtë saj, çdo 15 sekonda;

-Çdo muaj 50 mijë femra kanë kërkuar ndihmë nga organet kompetente;

-Vetëm 7% të femrave nuk kanë pësuar kurë kurrfarë sulmi apo ofendimi seksual;

-Nëse viktimat e dhunës familjare do të kapeshin dorë për dore gjatë vitit 1993 në ShBA, rendi do të zgjaste nga Nju Jorku deri në Los Angjeles.

Në Angli dhe Uells, vetëm në vitin 1987 janë dhunuar 22.239 femra, ndërsa janë bërë 120.060 aspekte të tjera të atakut apo ofendimit seksual.

Është interesant të theksohet se keqbërësit e këtyre veprave pranojnë që këto instinkte i shtyjnë të bëjnë dhunë seksuale:

- Prania e femrës në çdo vend me pamje provokative dhe ngacmuese;

- Ngacmimi i epsheve që çon në humbjen e vetëkontrollit dhe;

- Filmat pornografikë, revistat, gazetat e të ngjashme.

Diçka është e gabuar në thelb në shoqërinë ku jetojmë. Një ndryshim rrënjësor në mënyrën e jetesës të shoqërisë dhe kulturës është absolutisht i nevojshëm. Një kulturë modestie nevojitet dëshpërueshëm; modesti në veshje, të folur dhe në sjelljet e burrave dhe grave. Përndryshe statistikat e errëta do rriten edhe më keq ditë pas dite e, për fat të keq, vetëm gratë do ta paguajnë çmimin. Ç'është e vërteta, ne të gjithë do vuajmë, por siç ka thënë Khalil Gibran "...nuk është njëlloj për personin që kamxhikët i pëson, si për atë që i numëron."

Prandaj, një shoqëri si Franca që përjashton vajzat e reja nga shkolla për shkak të veshjes së tyre modeste, në fund të fundit, thjesht dëmton veten.

Është ndër ironitë e mëdha të botës sonë moderne sot se krejtësisht e njëjta mbulesë koke së cilës i tregohet respekt si shenjë 'shenjtërie' kur vishet për qëllimin e të treguarit të autoritetit të burrit nga murgeshat katolike, shahet rëndë si një shenjë 'shtypjeje' kur vishet për qëllimin e mbrojtjes nga gratë muslimane.

Qëndrimi i medhhebit hanefij rreth mbulesës

Në parim shkolla juridike hanefite mendon se femrës i lejohet ta zbulojë fytyrën dhe duart dhe se meshkujt kanë të drejtë të shikojnë fytyrën dhe duart e femrave, nëse ky shikim nuk është me pasion. Në veprën 'Bidajet'ul-mubtedi' shkruhet: "Nuk i lejohet mashkullit ta shikojë femrën e huaj, pos fytyrën dhe duart e saj."

Nëse shikimi është me pasion dhe epshe, apo kur në shoqëri mungon norma islame e sjelljes, sikur ulja e shikimit, juristët mendojnë se është detyrim të mbulohet fytyra si mbrojtje nga amorali.

Vehbi Sulejman el-Gavoçi, në komentin e veprës Multaka'l-Ebhur thotë: "Baza në medhhebin e Ebu Hanifes është që femrës i lejohet ta çelë fytyrën dhe duart kur është në mjedis ku meshkujt dhe femrat janë të ndershëm. Mirëpo, kur kjo bazë ndryshon dhe nuk është e sigurt nga fitneja, atëherë femra ka për detyrë ta mbulojë tërë trupin dhe duart, si preventivë nga fitneja dhe ajo që shpie aty". ■

Patriot nuk të bëjnë fjalët, por veprat!

Nuk kam as më të voglin dyshim se "profesioni" më i kollajtë ndër shqiptarë mbetet ai i "patriotit". Njëkohësisht, më i vështiri është ai i të qenit me të vërtetë patriot.



Demir RESHITI

Patriot (greqisht πατριώτης = atdhetar) – person që e do atdheun, person që e do atdheun dhe është i gatshëm që ta mbrojë, person tek i cili është i theksuar patriotizmi.

Patriotizmi është një ndjenjë komplekse subjektive dhe orientim me vlerë që përfshin ndjenjën e dashurisë ndaj atdheut, e armiqësisë ndaj të gjithë atyre që përpiqen ta rrezikojnë atdheun, si dhe gatishmërinë për ta mbrojtur vendin e dashur, apo shtetin, si një nga vlerat sublime.

Sipas historianit të kulturës, J. Huizing, fjala patriotizëm u paraqit në shekullin e XVIII-të, madje vetë shprehja patriot që vjen nga kuptimi burimor i bashkëvendësit dhe atdhetarit (patrie amans) – ai që e do vendlindjen e tij, është shumë më e vjetër dhe e ka prejardhjen nga antika. Kjo fjalë dallon edhe nga nacionalizmi, sepse nënkupton ndjenjën e përkushtimit dhe dashurisë ndaj atdheut, së bashku me të gjithë qytetarët e tij (të përkatësive të ndryshme etnike), e jo ekskluzivisht dashurinë ndaj kombit të vet. Ushqimi me ndenjën e patriotizmit paraqet një nga detyrat më të rëndësishme të edukimit shoqëror dhe familjar.

Historia tregon se Cezari ka pasur njerëz të përgatitur dhe të shkolluar enkas, të cilët kanë pasur detyrë që ta ushqenin popullatën e territoreve të okupuara me patriotizëm (dashuri) ndaj Romës, me qëllimin e ngritjes së aftësisë luftarake dhe të rekrutimit më të lehtë të rekrutëve të rinj. Më vonë, aktivitete të tilla u zhvilluan edhe në Iliri...

Patriotizmi duhet zhveshur nga politikanizmi dhe duhet kultivuar në formën e pastër të tij, që do të ishte vazhdimësi e traditës ilire të popullit shqiptar.

Patriotizmi – "profesioni" më i kollajtë ndër shqiptarë

Nuk kam as më të voglin dyshim se "profesioni" më i kollajtë ndër shqiptarë mbetet ai i "patriotit". Njëkohësisht, më i vështiri është ai i të qenit me të vërtetë patriot, siç e konceptonte patriotizmin Monteskje: "nëpërmjet dashurisë për njerëzit e mi, mësova që mbi të gjitha i përkas njerëzimit".

Patriotizmi nuk është detyrim moral, edhe pse në të shumtën e rasteve nënkuptohet si i tillë. Detyrimet morale janë universale, bie fjala si detyrimi që të mos heshtet apo të mos gënjehet për të vërtetën.

Mëdyshja për atë se patriotizmi është detyrim moral, paragjykoj se rrjedh nga strukturat shoqërore autoritare. Ata, nga të cilët pritet që të jenë patriotë, nuk marrin pjesë në sjelljen e vendimit në lidhje me atë se çka është akt patriotik dhe sjellje patriotike.

Ja disa karakteristika të patriotit shqiptar:

- Patriot është ai që nuk i hedh poshtë asnjëherë vëllezërit e një gjaku, pavarësisht nga dallimet krahinore, fetare, zakonore...

- Patriot është ai që flet gjuhen shqipe dhe mendon shqip në çdo sekondë të jetës së tij, pavarësisht se sa larg është fizikisht nga Shqipëria natyrale.


- Patriot është ai që braktis gjithçka në jetën e tij dhe shkon pranë atdheut të tij, për të dalë në mbrojtje të interesave kombëtare. Patriotët e vërtetë e kanë atdheun e tyre më të shenjtë se çdo gjë tjetër dhe janë gati të sakrifikojnë gjithçka për të, familjen dhe jetën e tyre.

- Patriot është ai shqiptar që di të bëjë dallimin midis interesave kombëtare dhe interesave politike. Interesat kombëtare qëndrojnë gjithmonë mbi interesat politike dhe i bashkojnë të gjithë shqiptarët pavarësisht nga bindjet e tyre politike.

- Patriot është ai shqiptar që ka një dëshirë dhe endje të madhe ta njohë historinë, traditën dhe kulturën shqiptare dhe t'ua përcjellë atë edhe pasardhësve të vet.

- Patriot është ai shqiptar që e ngre zërin e vet sa herë që dikush guxon të cenojë apo shesë interesat tona kombëtare. Të jesh shqiptar nuk do të thotë vetëm të kesh lindur i tillë, por të jetosh gjithë jetën tënde me përgjegjësitë që rrjedhin nga të qenit shqiptar.

Dhe ajo më kryesorja dhe e logjikshmja, për mendimin tim, është se patriot nuk të bëjnë fjalët, por veprat! ■



Halim Mejzini
Nga cikli Zogjët

Drejt teorisë së poezisë

Universalja thyen personalen në kohë

Koha nuk identifikohet më. Tani subjektiviteti prek të përgjithshmen për të jetuar në të përgjithshmen e botës reale. E gjithë kjo bëhet për të gjykuar më mirë për gjërat që ka përreth. Bota e pakufishme diskursive sjell fiksionin për letërsinë.



Flamur MALOKU

Poezia kah modeli jetësor

Diskursi i poezisë është shprehje e ndjenjës subjektive. Ky subjektivitet, i shprehur tani në gjuhën tekstuale, është çdoherë autentik, i motivueshëm në kohë dhe hapësirë. Mirëpo, kjo kohë autentike, subjektive e shtruar në diskursin e tekstit vetvetiu shkon drejt thyerjes së vetë autentikes. Tani subjektiviteti shkon më shumë drejt një përjetimi më të përgjithshëm për të gjetur të vërtetën jetësore - njerëzore. Ky përjetim i përgjithshëm në ligjërimin e poezisë *"Baladë për njeriun që nuk e njihte bota"* e *Eqrem Bashës*, shkon nga jeta, për t'u bërë një metatheksim, në hapësirën e pakufishme të fiksionit në diskursin e figurës. Pra, ndërtohet e tashmja ekzistenciale, për të shkuar nga e përgjithshmja - universalja, duke theksuar jetën, për të identifikuar dhembjen personale, karshi vetë jetës. Mirëpo, universalja tani thyen personalen e përjetuar në kohë. Koha nuk identifikohet më. Tani subjektiviteti prek të përgjithshmen për të jetuar në të përgjithshmen e botës së pakufishme. E gjithë kjo bëhet për të gjykuar më mirë për gjërat që ka përreth. Bota e pakufishme diskursive sjell fiksionin për letërsinë. Kështu, shkrimi bëhet metapërjetim për të mbërritur dhe për të theksuar çdoherë se bota e brendshme nuk duhet të njohë asnjë kufi në shprehje dhe në artikulimin e ekzistencës. Kështu poezia *"Baladë për njeriun që nuk e njihte bota"* kryqëzon atë që quhet jetë dhe ndjenjë, ku ndjenja dhe jeta shkojnë dhe universalizohen së bashku me personalen - ekzistencialen, për t'u rikthyer prapë në dhembje dhe në vetmi, çdoherë si ekzistencë, për një model i veçantë jetësor në shkrimin diskursiv. Diskursi letrar në të përgjithshmen - universalen, paraqet jetën si model të mundshëm, apo siç thotë Kujtim Shala: *"Letërsia jep pamje fiksionale të jetës/botës. Bota e letërsisë i ngjan botës reale, pa jetuar identifikimin me të"*. Kështu, bota e artikuluar në fiksion bëhet kërkim i përhershëm për të mbërritur në hapësirën universale, karshi shënjimit të vetmisë personale - impersonale, mallit, ekzistencës, etikës. Gjithnjë duke vënë para atë që quhet personale - universale.



Kohë pendimi

Koha e dikurshme në përjetimin personal, që bëhet edhe pendim, për të ardhur deri në gjetjen e personales, njohje kjo e vetvetes, tani e rikthyer në (unin), në poezinë *"Pendimi" të Milazim Krasniqit*, do të nënkuptojë edhe një vijë besimi, duke shkuar nga ajo lidhje, që mund të themi shpirtërore - universale. Shpirtërorja po zgjerohet në kohën dhe në hapësirën, ku uni do të shkojë nga ajo që trupi fizik do të identifikohet në besueshmërinë e plotë, për të sjellë diçka njerëzore në jetën e përditshme. Etika do të burojë nga ajo që është njerëzore, por në universalen e pakufishme, kjo do të bëhet mësim për njeriun, se si pendohet për kohën e vështirë. Prandaj, Milazim Krasniqi në diskursin e tij shkruan poezinë për të dëshmuar kohën e ligë, e cila kërkohet të harrohet, për t'u shtrirë në diskursin universal.

Pamje

Shihet që poezia në diskursin e saj shpreh autentiken e përhershme në kohë dhe hapësirë, mirëpo koha dhe hapësira po thyhen në diskursin e përgjithshëm - universal, po shkohet madje drejt gjetjes së të përgjithshmes, për të ardhur tek një njohje, nga vetja - njerëzore - morale. Poza po kërkohet si gjetje për veten, e për vetveten, atë që është humane. Kërkimin e vetvetes, si njohje për një pamje jetësore, e ofron letërsia. Për Musa Ramadanin, në poezinë *"Në gjurmim të vetvetes"* letërsia po bëhet njohje e rinjohje, për vetë jetën. Gjetja

e vetes po e thyen absurdin:

Brenda dekadës së fundit
Letratura u bë jetë
E jeta letraturë a thua
A thua pushova së gjurmuari më

Letërsia, po bëhet jetë, për vetë jetën e përditshme, po kryqëzohet dhe po identifikohet letërsia më jetën - njerëzoren. Absurdi, për Musa Ramadanin, nuk po shënjohet për letërsinë. Letërsia dhe arti, në përgjithësi, po bëhen të jetuara së bashku, për një njohje subjektive, çdoherë në përmasën universale, që po vazhdon së gjurmuari, vetëm e vetëm që të gjejë pakëz jetë.

Kohë pa emër

Koha e përjetuar nga subjektiviteti nuk ka emër. Poezia s'po njeh as emrin e kohës së trishtuar. Diskursi i figurës në strukturën shtresore të poezisë së Ibrahim Kadriut: *"Kohë pa emër"*, dëshiron të jetojë pa kohën e ligë. Ajo tani paraqitet vetëm si hije. Subjekti as që dëshiron të identifikohet më të. Mosidentifikimi më të, diskursin e poezisë e dërgon në universalen. Shkelen kohët njëra me tjetrën, të cilat shtrihen për t'u theksuar vazhdimisht në gjakim, vetëm si emocion i motivueshëm, për të kaluar më shumë në shenja dhe simbole. Shenjat ndërtojnë gjuhën e komunikuar, gjuhë e cila theksohet me dhembje dhe vuajtje. Kohët e vështira edhe ashtu nuk pëlqehen nga poeti, sepse ato bëhen korniza dhe poeti nuk dëshiron të mbyllet në kornizat e kohës. Kjo është poezia dhe bota e poezisë që të bën të identifikohesh në kohë dhe hapësirë. Duke shkuar nga jeta, në të veçantën personale dhe në të përgjithshmen, për të gjetur veten e vetveten - njerëzore - etike. ■



Lexim teksti

Përtej thellës

Zgjedhja e një figure të tillë në roman e bën më të lehtë zhvillimin e dialog



Gjylë TOTAJ

Romani "Fijet e shpirtit", i autorit Milazim Krasniqi, u botua për herë të parë në vitin 1998 dhe u ribotua me të njëjtin titull në vitin 2007. Në këtë ribotim vërehen disa ndryshime nga botimi i parë. Autori bën ligjërim të drejtpërdrejtë për dramat fatkeqe e jetësore që i goditën njerëzit në kohën e tyre. Duke iu referuar kohës së shkrimit të këtij romani dhe duke pasur parasysh të gjitha këto kohëra, që të identifikohemi me personazhin kryesor të këtij romani dhe që mund ta quaj hero të kohërave në roman, kjo lëndë e romanit mundë të rishikohet në dritën e kohërave dhe përvojave të reja, që janë të artikuluar me mjeshtri të veçantë artistike nga ana e autorit. Ndër personazhet e shumta që ka romani, autori ka përzgjedhur konkretisht si rrëfyes kryesor personazhin e artikujve të shumta të shkruara, personazhin e intelektualit të kohës së diskriminuar, të quajtur Besnik Shtylla, i cili ishte i martuar dhe kishte një vajzë. Zgjedhja e një figure të tillë e bën më të lehtë zhvillimin e dialogut me kohët, me hapësirat, me fluturimet jetësore e imagjinatave, në njërën anë dhe te kjo figurë sintetizohen përvojat jetësore, përvojat rikrijuese e mesazhet e amshueshme të tij, në anën tjetër. Të gjitha rrëfimet e romanit i kundërqendrojnë një realiteti të egër të kohës, apo një realiteti të hidhur, që ngjyros stilistikisht këto rrethana. Këtu gjejmë manifestimet narrative të personazhit dhe zhvillimet politike të kohës. Këtu autori veçon shtjellime e theksime të veçanta të dinjitetit të Besnikut dhe shumë kohë historike para tij të identifikuar me personazhet e historisë së kohërave të ndryshme, si parim i pakompromis për realizimin e qëllimeve atdhetare. Parimi më i lartë në këto rrethana është mosthyerja morale dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor.

Identifikimi me personazhin

Subjekti i këtij romani, i identifikuar me personazhin, na kthen të kalojmë në kohë nga më të ndryshmet. Emri dhe mbiemri i tij (Besnik Shtylla) ka një shtrirje që paraqet fortësinë e personazhit të shënjuar në kohë dhe fijet e shpirtit të tij na paraqiten herë të forta, herë të ngatërruara dhe nganjëherë të këputura nga ngatërresat. Ato janë të shumta, por njëra nga to është më e forta dhe më e qëndrueshmja, që i mban të tjerat dhe i bën të palëvizshme për jetën dhe idenë e tij, të identifikuara që nga kohërat më të lashta, duke filluar nga regjimi i egër romak dhe e trashëguar më pas nga bizantinët… Besnikun, heroin e romanit, autori e paraqet me vizion të qartë dhe ideja e tij kuptohet që në fillim të romanit: ideja dhe ideologjia e tij, apo ëndrra e kamotshme e shqiptareve, ishte bashkimi i Shqipërisë me Kosovën. Por, Besniku me shokët e tij, nuk mendonin nëse do të mund t'ia arrinin këtij qëllimi. Ai u sakrifikua në mënyra nga më të ndryshmet, pa u ndalur dhe pa u trembur nga regjimi i kohës. Pa dashje i kujtohej historia e kaluar e popullit të tij, gjë që e rrëqethte dhe nuk e linte të qetë. Arritja e qëllimit mund t'i kushtonte atij me jetë, ashtu siç u kushtoi shumë të tjerëve para kohës së tij, që kishin luftuar dhe sakrifikuar jetën e tyre për të vetmin qëllim që kishin. Idenë e Besnikut nuk mund ta evitonin të pashpirtët që qëndronin në krye të udhëheqjes së vendit. Kjo gjendje për Besnikun dhe për të gjithë të tjerët ishte e papranueshme dhe mjaft e vështirë për t'u tejkaluar.

Zbehja e ëndrrës jetësore

Inspektorit serb, të quajtur Stevan, me stafin e tij, çdoherë e më shumë

sive të "Fijeve të shpirtit"

gut me kohët, me hapësirat, me fluturimet imagjinatave.

vinte duke iu ngulitur në kokë ideja e Besnikut. Ai me bashkëpunëtorët e tij bënë plane për arrestimin e Besnikut dhe një gjë e tillë ndodhi, sepse ishte një kohë që nuk të krijonte as hapësirë që ta mendoje një qëllim të tillë, e jo më ta realizoje ashtu siç dëshironte Besniku, duke sakrifikuar edhe atë që kishte më të shtrenjtë, JETËN. Ata e panë Besnikun si një njeri të rrezikshëm për shkak të ideve të tij dhe ata duhej t'ua shtypin kokën ideologëve të këtyre ideve që reflektonin negativisht në regjimin e kohës. Ata morën vendimin për arrestimin e Besnikut. Ai u arrestua në mënyrën më misterioze. Të gjithë e përjetuan rëndë këtë lajm. Ishte e vështirë që një idealist siç ishte Besniku t'i shpëtonte kohës së egër. Për ta nuk mund të ishin të rënda vetëm shkrimet e tij, por, në themel të gjithë kësaj ishte urrejtja ndaj nesh si komb. Citoj një pjesë nga romani, të cilën autori e paraqet me mjeshtri të veçantë artistike:

"Ata kanë sajuar një përrallë se gjoja kjo është toka e tyre e shenjtë, djep i kulturës së tyre dhe tashmë janë bërë fanatikë në besimin se ajo që ka qenë thjesht një përrallë në fillim, tash është krejt e vërtetë. Këtu nuk mbetet hapësirë për asnjë veprim logjik, veçse për terror dhe për krime".



Realiteti, e lidhura shpirtërore

Dashuria ndaj Krijuesit të Botëve dhe dashuria ndaj Atdheut janë temat qendrore të romanit, për aq sa vetë ajo është pjesa thelbësore e ekzistencës së qenies. Mandej shkrimtari ndjek rrugët e artit dhe jetës. Aty përballë ëndrrës është realiteti. Botën e tronditur të narratorit e mban të fortë besimi që kishte në Zot. Autori e paraqet në mënyrë artistike luftën e mëkatit dhe mirësisë duke mbështetur në jetën e shqiptarit. Të gjitha këto që paraqet autori të shtyjnë të nënkuptosh se: dashuria për atdheun, për të qenë fitimtare, duhet të jetë e varur nga dashuria për Zotin e botëve. Të gjitha këto ia lehtësojnë Besnikut momentet e fundit të jetës. Atij iu kujtua fjala e babait se çdo gjë ka shteg dhe tani, tha me vete, ky është shtegu për të cilin më paska folur babai: fitorja e vërtetë arrihet vetëm kur bëhet për hir të Krijuesit të botëve. Mbi të gjitha, Besniku po ndjente një lehtësim në shpirt. E tërë hapësira e mendjes së Besnikut u ndriçua nga një dritë jashtëtokësore. Duke u mbështjellë i tëri me atë dritë, ai ndjeu lehtësimin e plagëve.

Pas torturave të shumta Besniku dha shpirt. Do të duhej të ndërtohej një përmendore, që do të ishte nderi dhe përjetësia e Ulpianës, siç e cek autori, duke thënë:

"Tërë jetën tonë të dhuruar nga Hyji, ne ia kushtuam veprës së mirë të besimit dhe të lirisë. Kush është ai që nuk e ka për detyrë të bëjë një punë me vlerë për lirinë dhe besimin e popullit të tij?"

Nga kjo që u cek, ne nënkuptojë mesazhin që jep autori: ne që jetojmë dikush na solli në jetë dhe secilit nga ne Hyji i ka caktuar një mision, por ka nga ata që nuk dinë t'i lexojnë shenjat që përmbajnë urdhrin hyjnor. Dhe ne duhet të kemi më shumë besim në përjetësinë e atdheut tonë, më shumë besim në vete dhe më shumë besim në arritjen e lirisë. Kohë-hapësirat që paraqet autori janë të shumta dhe të gjëra. Ai cek disa vende dhe disa personazhe duke përmbledhur një kohë të gjerë.

Autori i përmbledh me mjeshtri dhe gjeturi të veçantë konfliktin fetar dhe mëkatet njerëzore. ■

Poezi

Një rrugë e pluhurosur



Osman GASHI

EUKALIPTUSËT QE LUHATESHIN

Po përpiqem të të rrëfej:
Nuk gjej dot fjalë
Mbase as s'mund ta hap gojën
Fjalët më shpërthejnë nga bebëzat e buhavitura
Bashkë me lotët

Po përpiqem të të rrëfej
Për ditën kur e kisha parë
Përmbytjen
Për rrugët që gjarpëronin drejt Majës
Dhe Eukaliptusët që luhateshin

Po përpiqem të të rrëfej
Shenjat
Vetëtimat
Për cirkat e gjakut që rridhnin mollëzave

Dhe nuk (e) di si
Dhe nuk (e) di çka
Nuk di pse duhet të të flas
Të të rrëfej
Për
Dridhmat
Shtangien
Dhe mungesën e Frymës

ËNDËRR

Pashë një grua flokëshprishur
Një rrugë të pluhurosur
Dhe një karrocë që dergjej pranë

Pashë edhe një kandil të sapofikur
Dhe kundërmimin e tymit
Dhe letra të djegura
Dhe …

Lart në qiell
Retë që po mblidheshin
Dhe një krah të këputur zogu
Që kërkonte burimin

Ishte prill a maj
S'e thoshte ëndrra

I keni parë si fluturojnë kurrillat
Pikërisht ashtu
Ashtu
Po ngrinte
Po dergjej
Botë e mefshtë
Ndanë dritësores sime

RRËFENJË

Ishte nisur për të mbërritur
Dhe po vonohej
Se nata s'lëvizte

Pritja e kish kërrusur
E mori me mend
Se shiu që po ndjehej
Sakaq
Do të shpëlante mjegullën e kujtesës

Dua një qiell
Dhe një yll që shndrit në një qoshe të tij
Tha
Dhe fluturoi
Hapësirave të pambarimit

MYSHQE

Kur (ti) merr frymë
Mua më ther nën brinjë
Tkurrem
Palosem
Zhgrehem
Ngurosem

Nuk është herë e parë, as e njëmijta
Që më fiken yjet në sy
Që po shprishen penjtë e ëndrrave

Kur ti merr frymë
Anë e kënd detit si kandil
Vezullojnë sytë e kaltër të fokave

Myshqet na janë ngatërruar nëpër këmbë
Dhe në brinjën
Që më dhemb
Më pret
Më bluan

Më puth dorën që dridhet
Më mëkon nyejt e ënjtura

Kur s'sheh gjë
Kur s'pipëtin gjë
Ti je këtu
Brenda
A je?

Mrizi i bukurisë së njerëzve



Berat DAKAJ

Në fund të javës lexova Antologjinë e mendimit shqiptar 1870-1945 të Ndriçim Kullës. Brenda tij kalonin emrat dhe shkrimet antologjike (sipas Ndriçim Kullës) me në zë të historisë së mendimit shqiptar, të letërsisë, të gazetarisë, të kritikës, të eseistikës, të politikës: pra baballarët e vetëdijes kombëtare, politike, ekonomike, kulturore etj. Nga shkrimet e tyre, përshkruese, argumentuese, kritikues, polemizuese shpaloseshin bukuritë dhe shemtitë e Shqipërisë së asajkohshme.

Të gjithë nga ta, duke filluar nga Vaso Pashë Shkodrani, Sami Frashëri, Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Faik Konica, Fan Stilian Noli, Eqrem Bej Vlora, Branko Mërxhani, Mehdi Frashëri, Anton Harapi, Xhuzepe (Zef) Valentini, Vangjel Koça, Tajar Zavalani, Krist Maloki, Ernest Koliqi, Stavro Skëndi, Nebil Çika, Safet Butka, Ismet Toto, Nonda Bulka, Sejfull Malëshova, Zef Mala, Arshi Pipa e At Gjon Shllaku; pra, mendimtarët e Shqipërisë, rrethoheshin nga parti të ndryshme të interesit, nga njerëz këshilltarë të lartë zyrtarë, politikanë, ministra, zv.ministra e, edhe nga politologë njëkahësh, që disa ngjyeshin në të edhe vetë, ashtu siç ngjyejnë e ngjyrosen edhe sot në shtetin tim – në Kosovën foshnje.

Nga ky libër antologjik i Kullës, që mora jo vetëm për ta kujtuar krijimtarinë e këtyre të përmendurve, por edhe për të lexuar, nga ndonjëri prej tyre ndonjë shkrim publicistik ose eseistik për herë të parë, mësova edhe më tepër se si mund të nxirret një paralele mes pamjes së shtetit të Shqipërisë së dikurshme dhe Kosovës së sotshme, por edhe të udhëheqësve të saj të sotshëm, pse jo edhe të politologëve dhe gazetarëve që i përcjellin njëri-tjetrit në kafene fjalët e kafeneve të zyrtarëve të qeverisë.

* * *

Kosova është një vend i vogël që rrënon shëmtinë dhe ndërton bukurinë, por brenda kësaj bukurie të saj është lëshuar shëmtia. Nuk ka kaluar shumë kohë qëkur kjo Kosovës është bërë shtet (afro tre muaj). Vendet e punës për punonjës, por edhe për punëtorë krahu në këtë vend kanë filluar të hapen. Por e keqja është që punojnë dhe jetojnë sot për nesër. Rrogat e tyre janë sa për të mos u shtrirë si Fadili shtatëgjatë, flokëgjatë, mjekërgjatë në mes të rrugës në diell, në shi, në borë, dhe sa për të mos ua zgjatur dorën e ngrehur zërin njerëzve me halle-halle që kalojnë pranë teje kokulur; ose edhe që, sapo të shohin e të dëgjojnë zërin kërkues e lutës Zoti të ruajtë, kthejnë kokën në drejtim të kundërt. Në këtë rreth të njerëzve parakalues, ka disa që janë shumë të dëshpëruar, që nuk kanë as para për të blerë domestos për të bërë vetëvrasje më të lehtë, pavarësisht atyre që, kur nuk gjejnë në ndonjë qoshe të banjës domestos, ose në orman bensedin, varin veten me litar të komshive.

Në këtë shtet të sapoformuar janë ngritur dhe kanë rënë shumë figura, së bashku me qeveritë e tyre. Ndonjëra ka çuar pluhur më shumë se tjetra për të keq, ndonjëra është treguar pak më e butë! Megjithëqë, deri më sot, akësecila i shërbyen vetes për një qëllim: interesa vetjake.

Ja se çfarë ndodh me një zyrtar të lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ai megjithëqë ngre pas vetes titull të gjatë dhe epitet shumë të fryrë, ai, fatkeqësisht, merr pagë shumë të ulët; kështu, fatkeqësisht, merr pagë po kaq të ulët 195 euro - minus paratë ndarë Trustit të Kursimeve Pensionale, mbetja 180 euro (për 31 ditë, pra për 744 orë) - një bibliotekar ose bibliotekiste në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, të cilët vazhdimisht kujdesën dhe ruajnë Objektin e Gjurmëve, që është dashur që herët t'i shkulin rrënjët e tyre nga aty.

E, po pëlqeve të ecësh këmbë nëpër kryeqëndren e këtij shteti foshnje, përpos gjërave të parregullura dhe të pavend, syri të sheh edhe gjëra me vend, të bukura, përpos atyre të shëmtuara, shumë natyrale, ngjitur me ato jazhtëzakonisht artificiale. Por, po në rrugën "Nënë Tereza", afër duhantores Tobacco, syri të sheh edhe Shqipërinë Natyrale të Koço Danajt; e, po re përmes kësaj qëndre, në të dy sytë shumë lehtë mund të bie pluhuri që ngrihet nga graniti i shtrenjtë e i thyer i ndërtuar pak para 17 shkurtit.

* * *

Sa më vinte çudi kur, në një pjesë të publicistikës së Konicës që lexoja të enjten e 9 majit 2008 në librin e Kullës, i cili kishte përzgjedhur disa shkrime të Konicës, i cili pati shkruar në atë kohë për Shqipërinë dhe dukjen e saj, më bëhej sikur ky ambasador i Shipërisë në Amerikë (i zgjedhur në vitin 1925, pas Revolucionit Demokratik-Borxhez të Qershorit), të jetë mu në mes të Prishtinës.

Dukja e Shipërisë në publicistikën e tij ishte madhështore, në Kosovën time foshnje. Por ato që i lidhnin këto dy vende, tash për tash artificale, si për çudi, ishin atje dhe këtu, atëherë dhe tash: "Një grusht njerëzish në Shipëri kanë mundur të mbajnë e të shtojnë rrogët e tyre dhe të rrinë të patundur në mes të fortunave. Këta janë njerëz të vetëquajtur 'ekspertë'. Shqiptarë dhe 'ekspertë'! Po 'ekspertë' në çdegë?

Në gjithë degët e botës, - dhe në ca të tjera përveç të gjithëve. Burimi i këtyre njerëzve asht i ndryshëm. Ca kanë dalë nga administrata e Turqisë, ku kalbeshin në latrinat e huqumeteve si kapistë; ca janë ngritur nga moçalet dhe llucat e Myzyeqesë ose të Durrësit dhe janë sulur të rrinë në frona, pa fshirë baltën e njomë nga opingat e tyre. Guximi dhe paturpësia e tyre zunë vendin e diturisë, serviliteti i tyre në të zotërit e ditës zunë vendin e shërbimeve të kombit". {...}. Po 'ekspertët' janë në vend të tyre, me të patundur se Dajti, më të fortë se Tomori".

E, në foshnjën tonë - Kosovën - edhe pse pranvera e parë e bukurisë së pavarësisë së saj është e shtrirë çdokund, bukuria e saj ndërmjet njerëzve është e shëmtuar. ■

Haqif Mulliqi dhe "Kaos atdhedashurie në Paris"

Kulla e Parisit sinonim i kullës shqiptare

Dominon sarkazma në metaforën e një shtruarje për ta zbërthyer absurditetin



Naser SHATROLLI

Vikendin e kaluar me disa miq vizituam Tetovën. Motivi ishte i fuqishëm, atje do të shfaqej premiera e shfaqjes "Kaos atdhedashurie në Paris" me autor&regjisor Haqif Mulliqin, si dhe me aktorët Ismet Azemin dhe Senad Abdulin. Kaluam goxha kilometra duke debatuar për teatrin, filmin si kompleksitet më vete dhe, si përfundim, çudi, ka të atillë që udhëtojnë me dhjetëra kilometra për të ushqyer varfërinë e tyre "artistike" me ethe, me vlera të mirfillta krijuese, për të marrë guximin për t'i sulmuar ato vlera, si rehabilitim mental i tyre. Pra, ky fenomen po gjen ende strehë tek ne karshi dinamikës së përparuar. Atje ne takuam krijues nga Prishtina, si Agim Selimin, Fahri Hysajn, Afrim Spahiun, Adem Zhitopotokun etj, që kishin ardhur enkas për këtë eveniment teatror. Shfaqja për subjekt kishte: Çlirimin e trojeve shqiptare, si ide e mërguar në egzil e kamuflim për krijim fondesh. Përderisa si koncept ka për qëllim tejkalimin e atij mentaliteti të vjetër në raport me kohën, pra sfidimin e biçikletës si personifikim kohe në ecje, njëkohësisht në vizion për t'u futur në binarët e trenit modern, ku do vij në shprehje shpejtësia, përsosmëria kohore si afirmacion, zëvendësim të postierit klasik, luftës klasike, artit klasik si "patos" me dinamikën jetësore me konkretin etj.

Metaforë e fuqishme

Pra, do dominojë sarkazma në metaforën e një shtruarje për ta zbërthyer absurditetin e kullës së famshme shqiptare në vlerën si baraspeshim me kullën e Parisit "La tour Eiffel" dhe keqpërdorimit të saj nga matrapazët e kohës, në eufori, si njollosje e një ambicie të sëmurë të tyre "antivlerë e shitur për vlerë" e mbështjellë me petkun e UÇK-së. Vërtet, e bartur në dy tipa karakteresh, disidenti Agroni (refugjat politik), interpretuar nga Senad Abduli dhe analfabeti Ujkani (refugjat ekonomik), interpretuar nga Ismet Azemi të cilët jetojnë në të njëjtin pullaz mërgimi në të njëjtin krevat, duke masturbuar për 20 vite radhazi ilegalisht dhe duke planifikuar "kaos" demonstrata me të vetmin qëllim për t'i shfrytëzuar ato emocione të brishta të mërgatës dhe për të krijuar fonde "atdhedashurie" si mbulesë për t'u dëfryer nëpër bordelet e Parisit. Pra, e gjithë tragjedia e kësaj komedie do luhet brenda një dhome të zbrazët me një krevat të vetëm i cili do shfrytëzohet si tren, taksi, po edhe fole e prostitucionit dhe, në fund fare, do shndërrohet në institucion "politik". Pra, ky krevat vjen si metaforë e fuqishme në personifikimin e varfërisë kohore në të gjitha kuptimet, një vizion i frikshëm për kohën e tanishme si mesazh dramaturgjik. Këto koka do t'i shohim të instaluara edhe sot nëpër vende të peshuara, në anën tjetër, shohim një tavolinë, kur me paratë e vjedhura në mënyrë diplomatike, do të ushqejnë pangopësinë e stomakut të tyre me mishra-pemë-uiski, për ta ngrohur artificialisht atë (stomakun) dhe kokën deri në dehje, për të marrë guximin e të vepruarit të paktën përbrenda fiksionit, hijes së tyre. Do të marshojnë brenda dhomës së tyre si vigajt e Fishtës me hapa ushtarakë drejt "atdheut" për ta nxjerrë në pah ambicien, dashurinë e tyre të rrejshme për Kosovën, Tetovën, Ulqinin, Çamërinë, për trojet shqiptare. Duke e planifikuar si veprim për "20 vite" për të vazhduar me "vullnet" dhe për të mos mbaruar kurrë "ambiciet". Për të gjitha këto vite, valixhet e tyre do presin nisjen për t'u hapur diku në Kosovë, si ide për të parë dritën e vërtetë të tyre në "DOSJE", por që fatkeqësisht do mbetet e mbyllur së bashku me identitetin e tyre. Do mbeten të fjetur ilegalisht kudo, edhe në atdhe, pa familje, pa para, pa bordele dhe e vërteta e tyre do mbetet një imazh i keq i së kaluarës dhe mesazh i fuqishëm për të sotmen.

Një moment i pakapërcyeshëm

Mbase momenti më i rëndësishëm për suksesin e shfaqjes është spektatori, fundja për atë edhe bëhet shfaqja. Skena, thellësia, hapësira e atij teatri ishte e mrekullueshme, njëkohësisht e frikshme për aktorin, sidomos mbushja e sallës plotë e përplot me shikues, mbi 500 spektatorë, patjetër krijonte përshtypjen e të paragjykuarit, se si do të mbulohej vetëm me dy aktorë bazë. Por, kjo ndjesi frike, ky përjetim i paragjykuar u tejkalua që në fillim, falë potencës, punës, mbi të gjitha guximit aktoresk dhe regjisorial. Ishte meritë e të gjithëve, mbi të gjitha vulë teatrore e mjeshtrit të dramaturgjisë shqipe, Haqif Mulliqit, i akuzuar si "fajtor" për magji krijuese për mrekullitë që ai trason tek shikuesi për veprat e tij voluminoze, mbi të gjitha për dashurinë e madhe që ai ka për artin. Krejt për fund do të shohim një skenografi shumë dimensionale dhe funksionale të shfrytëzuar maksimalisht, një muzikë origjinale të ndërthurur me rrethanat, kostumografi në harmoni me idenë, ndriçim të dizajnuar skajshmërisht deri në detaje, gjithashtu, imazhe të përziera teatër-film, si koncept origjinal i autorit, pra Haqif Mulliqit, për të mbërritur tek aktrimi i Senad Abdulit dhe kreativiteti i shkëlqyer që ai na dhuroi deri në fund, si dhe aktrimi i Ismet Azemit, fjala e të cilit vjen si simfoni, si violina amato, si zbulim, si prurje e re për ato rrethana, e mbështjellë me nota poetike, me plasticitet dhe gjestikulacion në harmoni me interpretimin, i cili tek spektatori do të vijë si oshtimë deti, pra, performanca e tij do të futet thellë në themelet dhe muret e atij teatri, të asaj shtëpie kulti, si frymëzim për brezat në kuptimin e të jetuarit, si kontribut, si tym i bardhë, si letërnjoftim teatror. Lojë të mirë na dhuruan edhe Elmiri dhe Naimja, për aq sa kishin hapësirë. ■

Në fshatin Zgatar të Opojës u mbajt manifestimi tradicional poetik "Ora e madhe letrare e Ymer Prizrenit"

Festë poetike në Zgatarin e Ymer Prizrenit

Ditëlind RESHITI

SHARR, QERSHOR

Në fshatin Zgatar të Opojës është mbajtur manifestimi tradicional kulturor poetik "Ora e madhe letrare e Ymer Prizrenit", të cilin e organizon çdo vit klubi letrar "Luigj Gurakuqi" i Sharrit në bashkëpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës. Këtë vit, manifestimi kishte karakter jubilar sepse është mbajtur me rastin e 130 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ftesës së organizatorit për të nderuar këtë manifestim dhe personalitetin e madh të Lëvizjes Kombëtare i ishin përgjigjur shumë mysafirë nga e gjithë gjeografia shqiptare. Kishte aty poetë nga Kukësi, Tetova, Presheva, Prishtina, Gjakova, Prizreni, Hasi..., pastaj përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, TMK-së, veteranë të UÇK-së, përfaqësues të SHPK-së, UNMIK-ut, KFOR-it, përfaqësues të institucioneve komunale etj.

Manifestimi është hapur me himnin e flamurit të cilin e kanë intonuar nxënësit e shkollës fillore "Ilmi Batjari" të fshatit Blaç nën udhëheqjen e arsimtarit Mahmut Mahmuti.

Në emër të fshatit Zgatar, manifestimin e ka përshëndetur veprimtari i këtij fshati Fadil Misini, ndërsa një fjalë përshëndetëse e ka mbajtur kryetari i komunës së Sharrit Salim Jenuzi.

Manifestimin e ka shpallur të hapur njëri nga drejtuesit e klubit letrar "Luigj Gurakuqi", Bedri Halimi, i cili pasi ka përshëndetur të pranishmit, ka falënderuar donatorët të cilët me kontributin e tyre financiar kanë mundësuar që ky manifestim i madh kulturor ta vazhdojë traditën e organizimit. Halimi, me këtë rast, ka veçuar presidencën e Kosovës e cila e ka mbështetur këtë aktivitet me një shumë të konsideruar mjetesh, si dhe disa ndërmarrje private të komunës së Sharrit të cilat gati për çdo vit mbështesin financiarisht këtë aktivitet.

Orës së madhe letrare, si pjesë qendrore e këtij manifestimi, i ka paraprirë Ora historike, në të cilën janë shpalosur të dhëna të reja për personalitetin madhor të Ymer Prizrenit. I pari e ka marrë fjalën studiuesi nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, prof. dr. Zymer Neziri, i cili ka folur për trajtimin e figurës së Ymer Prizrenit në letërsinë popullore dhe në folklor.

Orën historike e ka përmbyllur mr. Enver Batiu me disa të dhëna të reja për figurën e Ymer Prizrenit.



Në orën letrare lexuan 20 krijues nga e gjithë gjeografia poetike shqiptare

Pjesën qendrore të manifestimit, Orën e Madhe Letrare të Ymer Prizrenit, me një fjalim rasti, në emër të kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, e ka përshëndetur shkrimtari Mexhit Mehmeti. Ai me këtë rast e ka përgëzuar organizatorin duke theksuar se manifestime të tilla duhet të mbahen edhe nëpër komunat e tjera.

Dardan Halimi me deklamimin e disa fragmenteve nga "Poemi Kosovar" i Mitrush Kutelit i ka paraprirë Orës së madhe letrare, në të cilën kanë lexuar poezitë e tyre 20 krijues nga mbarë gjeografia poetike shqiptare (Kukës, Tetovë, Preshevë, Bujanovc, Medvegjë, Prishtinë, Drenicë, Prizren, Gjakovë, Sharr... Poetët: Besim R.Cengu, Ekrem Ajruli, Mexhit Mehmeti, Abdullah Thaçi, Demir Reshiti, Demush Berisha, Nebih Bunjaku, Bilall Maliqi, Besim Muhadri, Reshat Sahitaj, Rexhep Smajlaj, Bedri Halimi, Riza Greiçevci, Berat Batiu, Ismet Lecaj, Besim Z. Cengu, Jonuz Fetahaj, Hatim Neziri dhe Mitat Fejza, janë mirëpritur e duartrokitur gjatë nga të pranishmit e shumtë në ambientet e shkollës së fshatit ku u mbajt ky manifestim.

Artistë edhe nga treva e Gorës

Pjesën muzikore të manifestimit e ka hapur grupi i këngëtarëve nga fshati Zgatar. Janë mirëpritur nga të pranishmit edhe këngëtarët e njohur nga Opoja, Nexhat Qusaj e Ajni Sadiku, rapsodët e njohur kuksianë Nexhmidin Voka, Milazim Halili e Ferid Dida, vëllezërit Mirhat e Riat Lecaj, pastaj këngëtarët e mirënjohur Hamzë Llapçeva e Masar Sinani.

Një befasi të këndshme tek të pranishmit kanë krijuar vëllezërit nga Restelica e Gorës, Nail e Hasan Mushka të cilët fillimisht kanë ekzekutuar një melodi me kavall e më pas edhe dy këngë, njërën në gjuhën shqipe e tjetrën në gorançe. Është duartrokitur gjatë sidomos kënga "Vijnë pampurat...", që me aq përkushtim e kanë kënduar në gjuhën shqipe vëllezërit Mushka. Përveç këtyre dy këngëtarëve, nga Restelica kishin ardhur për ta nderuar figurën e Ymer Prizrenit edhe një grup valltarësh, të cilët ekzekutuan dy valle tradicionale gorane nën përcjelljen e tupanëve e surleve. Pjesën artistike të programit e ka përmbyllur SHKA "Bresana" nga Bresana, e cila nën udhëheqjen artistike të Myzafer Lutfiut ka shfaqur një program të pasur folklorik me motive nga Opoja. ■

Alergjia - sëmundje e ditëve të nxehta

Alergjia mund të paraqitet në çdo moshë dhe prek të dy gjinitë, por më e shpeshtë është mes moshës 20-40 vjeçare, d.m.th. prek më shumë moshën aktive, por nuk është e rrallë edhe te fëmijët e sidomos ata mbi moshën 5 vjeçare.

Artan N. BEJTA

Ditët e nxehta të pranverës dhe verës, edhe pse shumë të këndshme për një numër të madh njerëzish, paraqesin problem të madh për shumë të tjerë, pasi ardhja e këtyre stinëve paralajmëron doemos edhe rishfaqjen e alergjive të shumta, sidomos e atyre që shkaktohen nga poleni i luleve, bari dhe pluhuri. Njerëzit që janë alergjikë ndaj polenit të luleve, barit dhe pluhurit, me ardhjen e këtyre stinëve janë të vetëdijshëm se do të kenë lot dhe kruarje të syve, teshtitje të shpeshta, rrjedhje hundësh me sekrecion të kthjellët etj.

Kësaj i ndihmojnë edhe temperaturat e larta në këto stinë e po ashtu edhe ndotja e madhe e ambientit nga automjetet dhe nga faktorë të tjerë të ndryshëm.

Alergjia mund të paraqitet në çdo moshë dhe prekë të dy gjinitë, por më e shpeshtë është mes moshës 20-40 vjeçare, d.m.th. prek më shumë moshën aktive, por nuk është e rrallë edhe te fëmijët e sidomos ata mbi moshën 5 vjeçare.



Çka është alergjia?

Alergjia, në të vërtetë, është një ndjeshmëri e tepërt e organizmit ndaj disa substancave të caktuara që nxisin një reagim të tepërt të sistemit mbrojtës të organizmit dhe, në këtë mënyrë, sistemi mbrojtës i organizmit tenton t'i eliminojë këto substanca të huaja me anën e mekanizmave të ndryshëm, duke shkaktuar reaksione të ndryshme në organizmin e njeriut. Zakonisht, luftimi i këtyre substancave të huaja për organizmin e njeriut bëhet përmes krijimit, nga ana e organizmit, të antitrupave të ndryshëm, të prodhuara zakonisht nga një lloj i qelizave të bardha.

Cilat janë simptomat e alergjisë?

Alergjitë mund të shkaktojnë shfaqjen e disa simptomave që varen nga shkaktari i alergjisë.

Zakonisht tek alergjia që shkaktohet nga poleni i luleve, pacienti ankohet për teshtitje të shpeshta me spërkla, rrjedhje të ujshme nga hunda dhe sytë, kruarje dhe skuqje të hundës dhe të syve, mosdurim të dritës (fotofobi), e po ashtu mund të ketë probleme me frymëmarrjen, si kollë dhe simptoma të përgjithshme, si dobësi trupore, dhembje koke, ankth etj.

Shkaktarët më të shpeshtë të alergjisë

Një nga shkaktarët më të shpeshtë të reaksioneve alergjike pa dyshim është poleni i luleve, por nuk janë të rralla edhe alergjitë e shkaktuara nga pluhurat e ndryshëm, qimet e kafshëve, puplat e shpendëve etj, e shumë e shpeshtë mund të jetë edhe alergjia shkaktarë të së cilës mund të jenë ushqimet e ndryshme dhe barnat. Alergjitë që shkaktohen nga poleni, pluhuri dhe ushqimet e ndryshme janë të mundimshme, por jo shumë të rrezikshme. Ato të shkaktuara nga barnat e ndryshme janë shumë të rrezikshme dhe ndonjëherë fatale.

Për paraqitja e alergjisë tek fëmijët



shpesh fajësohen edhe faktorët gjenetikë. Nëse fëmija ka alergji, e po ashtu ndonjëri nga prindërit ka pasur alergji, atëherë rreziku që sëmundja të jetë e trashëguar është rreth 40 %, e nëse të dy prindërit kanë pasur alergji gjatë jetës së tyre, atëherë rreziku që fëmija ta ketë të trashëguar këtë sëmundje është rreth 80 %.

Po ashtu, faktorë rreziku janë edhe faktorët e ambientit, e sidomos kontakti i shpeshtë me kafshët shtëpiake, si me mace, qen, që janë kafshët që biem më së shpeshti në kontakt, si dhe ndotja e ambientit nga ndotës të ndryshëm.

Këshilla me vlerë

- Ruajuni nga kontakti me lulet dhe me pluhurin, ose nga gjërat e tjera për të cilat dyshoni se ju shkaktojnë alergji;
- Të keni kujdes në ditët e nxehta dhe me erë, sepse në këto kushte përqendrimi i polenit në ajër është në maksimum;
- Mos i fërkoni sytë edhe pse keni ndjenjën e kruarjes;
- Evitoni ushqimet që kanë në etiketë aroma natyrore;
- Mos përdorni ilaçe pa u konsultuar me mjekun;
- Mos pini cigare dhe evitoni ambientet ku pihet duhan;
- Ambienti ku qëndroni të jetë i pastër dhe pa aroma artificiale (parfume).

Mekanizmi i veprimit të alergjenit në organizëm

Pasi alergjeni bie në kontakt me antitrupat e krijuara nga organizmi, atëherë kemi lirimin, nga ana e organizmit, e një mediatori të njohur me emrin histamina, që është substancë kimike që shkakton skuqje, fryrje ose ngushtim të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, si dhe uljen e presionit të gjakut. Në rastet kur organizmi bie në kontakt me baktere ose viruse, këta mediatorë mbrojnë trupin nga infeksionet e ndryshme.

Alergjia në ushqime

Jo më pak se 7 milionë amerikanë vuajnë nga alergjia për shkak të ushqimit dhe rreth 8 për qind e artikujve ushqimorë janë përgjegjës për 90 % të rasteve të alergjive ushqimore. Në këta artikuj, në rend të parë, renditen kikirikët, arrat, peshku, vezët, etj. Tani është bërë shumë i njohur rasti i 15 vjeçares Christina Desforges nga Kanadaja, që kishte vdekur 9 orë pasi kishte puthur të dashurin e saj, i cili kishte ngrënë një senduiç me gjalpë kikirikësh dhe shkaku i vdekjes së saj ishte pikërisht ai gjalpë kikirikësh, pasi ajo kishte qenë alergjike ndaj kikirikëve.

Kujdes nga ekrani i kompjuterit

Një studim i ri, i bërë nga shkencëtarët suedezë, ka treguar se edhe njerëzit e shëndetshëm mund të bëhen alergjikë duke qëndruar një kohë të gjatë përpara ekranit të kompjuterit. Nga të gjithë të testuarit të përfshirë në studim dhe që ishin të ulur me shpinën përkundrejt ekranit, u vu re se në dy të tretat e tyre rezultoi prania e një sasie të lartë të një lloji qelizash, të quajtura qeliza "maste", të cilat sjellin një kundërveprim alergjik.



Mjekimi i alergjisë

Shenjat që jep alergjia janë të ngjashme me at që jep një gjendje e zakonshme gripi dhe të gjithë në fillim e marrin si një gjendje gripi, por, në këto raste, njeriu duhet të shkojë të këshillohet me mjekun, ngase shpeshherë simptomat që jep alergjia mund të marrin përmasa dramatike. Mjeku (alergologu) bën testin e alergjisë dhe përcakton shkaktarin e reaksionit alergjik dhe, si rrjedhojë e kësaj, ju jep terapinë përkatëse dhe, në këtë mënyrë, do t'u lehtësohen simptomat. Edhe pas kësaj, duhet pasur gjithmonë kujdes nga shkaktari që ka shkaktuar alergjinë dhe duhet të kini sa më pak kontakt me të, e nëse jeni alergjik ndaj ushqimeve të caktuara mos i konsumoni ato, nëse jeni alergjikë ndaj barnave, atëherë mos harroni t'i tregoni mjekut gjatë vizitave tuaja mjekësore. ■

Fjalëkryqi

Autor: ENDRITI	PËRPJEKJE (shq.)	POEMA E HOMERIT	MARKË E VESHJEVE SPORTIVE (Origjinal)	KASHMIRI OVERSEAS ASSOCIATION	ZBAVITËS, TËRHEQËS	HEQJE E LIRISË, BURGOSJE (shq.) / BASHKËT-INGËLLORE		FUTBOLLISTI SPANJOL GONZALEZ	TONI, SULFURI, AMERPI	INTER TOTO		TURK I VJETËR	KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE NELLY	MORI, HEJ
AKTORJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO											"F" në mes të dy "O" / INSTITUTION ENGINEERING TECHNOLOGY			
KONGRESMENI AMERIKAN ENGËLL						QËLLUAR RASTËSISHT NË NJË NDODHI / "D" në mes të dy "A"								
SHTET NË AMERIKË (Kryeqytet Managua)										AI ME TË CILIN QUHEMI / SMALTI				
TANTALI, ELEKTRONI				TRAJNERI YNË VOKRRI / LLOJ HELMI LUFTE (shq.)					SHTET (fr.) / TRULLOSUR, QË I KA RA TË FIKËT					KRYEVEPRA E LEONARDO DA VINÇIT
AFËRDITA DEMAKU			NUK KAM / NDËRTESË E POSAÇME KU SHFAQEN FILMA					ADEM MIKULLOVCI			FAMË / KRUJA			
FUQI, FORCË						ISTRES / KËNGËTARJA TURKE ..... XHAN		PJESË E DREDHUR E LITARIT / FEMËR ZGJEDHUR				NOTË MUZIKORE / LLOJ, SOJ (sh.shq.)		
ZANORE		PJESË E SYRIT / E TMERRUARA, E TRISHTUARA					MILANO (shk.) / QENIE MBINJERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË				TONELATË / CIK ...			
ERDHA, PASHË, FITOVA (Latinisht - Thënie e Jul Cezarit)													ZANORE / HOV, VRULL	
AKTORI I NJOHUR DELON					SPIKERJA .... ÇEKU - BUÇINCA / FUTBOLLISTI PORTUGEZ LUIS					THIRRJE QË I BËHET MASËS / MENDIM				
	KËNGËTAR I SHQUAR AMERIKAN / AKTORJA JONË E FAMSHME DUSHKU							METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT (shq.)						
KËNGËTARJA JONË BYTYQI				PËRGJIGJJE NË TELEFON / BODRUMI I PIJEVE				OMANI, DARFURI / KËNGËTARJA E VJETËR SHQIPTARE TAKE			GOTË E BAKRIT (krah.) / ROTERDAM			
"LENGBORD"			EIGSBURG, NANTES / QË NXË SA NJË OKË			KËNGËTARI YNË BERISHA / ARKA						NAIM AABZI		
QESËNDISËS, TALLËS							NAIROBI, UGANDA / KËNGËTARJA KANADEZE DION							
LEGJENDË E FUTBOLLIT BRAZILIAN					BANOR I NJË SHTETI TË LASHTË AZIATIK									
					PJESË E LOJËS NË TENIS				BESNIK (perkdh.)					
LLOJ SHPENDI (sh.shq.)	VEGËL MUZIKORE / EDVIN MURATI				FUTBOLLISTI ANGLEZ SMITH (orgj.) / URUGUAI, TAJLANDA									
						IVREA / OSAKA		ILION / ZANORE						
DËSHIRA E MADHE PËR TË MARRË VESH DIÇKA (krah.) / SHUMË I GJATË														

